

**Informacion per  
Shoqeria “V.A.L.E. RECYCLING”Sh.p.k.**

**Nipt:** L28029301Q  
**Adresa:** Fushë Kuqe, fshati Gurëz, afër ish kanalit të acidit

**Veprimtaria:** **MENAXHIMI I MBETJEVE**  
5.1 a. Incinerimi i mbetjeve të rrezikëshme në një instalim incenerimi.  
5.3 a. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përvec incenerimit (5.1 a) ose landfillimit (5.2 a)  
5.4 a. Rikuperimi i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R1, R5, R6, R8 ose R9

**Pergatiti materialin:**

**Eneida MARA**

**Odeta ZHEKU**

**Anila GISHTI**

**TABELA PERMBLEDHESE**

- 1. PARATHENIE**
- 2. KUADRI LIGJOR**

3. QELLIMI DHE KARAKTERISTIKAT FIZIKE TE PROJEKTIT
4. PROCESET DHE LINJA TEKNOLOGJIKE QE DO TE SHTOHEN NE IMPIANTIN EKZISTUES
5. PERSHKRIMI I RAJONIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETI
6. VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS
7. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT

### ***PARATHENIE***

Industria është celësi i zhvillimit ekonomik të një vendi, por njëkohësisht hyn në radhën e ndikuesve më të mëdhenj në mjedis. Përmes zhvillimit të industrisë

---

harxhohen resurset si: burimet energjetike, uji dhe resurset tjera. Nga aktivitetet industriale clirohen emisione në ujë, ajër dhe tokë.

Zhvillimi ekonomik i cili po shoqërohet me rritje të vazhdueshme të numrit të ndërmarrjeve operuese, si rrjedhojë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis. Zhvillim ekonomik do të thotë mirëqënie e përhapur dhe ofertë prodhimesh gjithnjë e më të shumtë dhe të ndryshëm. Por rritje e konsumeve do të thotë edhe një sasi e madhe mbeturinash. Çdo ditë prodhojmë një sasi mbresëlënëse e gjithnjë në rritje të mbeturinave ndonjëherë të braktitura e të lëna pa kujdes: një peshë e papërbalueshme për mjedisin tonë, tashmë të lodhur nga shumë forma ndotjeje. Të prodhosh dhe të hedhësh sasi të mëdha mbeturinash vlerësohet sot një fakt i qartë, pothuaj si pjesë e natyrës njerëzore. Ky zhvillim nuk mund të jetë i qëndrueshëm, nëse nuk parashikon hapësira për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Varësisht prej veprimtarisë, ndikimi i operatorëve ekonomik është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit si në ajër, ujë dhe në tokë.

Mbetjet dhe trajtimi i tyre në territorin e Shqipërisë është një nga problemet e mëdha mjedisore ndonjëherë ndikimi i tyre në shëndetin e njeriut është më i madh se ndotes të tjera. Sidoqoftë, mbetjet (solide ose ujore/ujerat e zeza) ndikojnë në komponente të tjera mjedisore si uji, ajri, toka dhe nëpërmes zinxhirit ushqimor dhe/ose kontaktit direkt me keto është mjaft i madh.

Mbetjet ndodhen ngado dhe kultura se bashku me mungesën e financimeve dhe sidomos ndërgjegjesimi i popullsisë dhe rritja e përgjegjësive se autoriteteve lokale mbeten sfida për të ardhmen. Nuk mund të kete produkte bujqesore të pasterta, shëndet të mirë, burime ujore të pa ndotura, biodiversitet, turizem dhe cilesi jete të larte ne se nuk manaxhohen mbetjet e ngurta dhe ujerat e zeza.

20% e mbetjeve spitalore janë të kategorizuara si mbetje të rrezikshme dhe në momentin që këto mbetje janë në kontakt me objekte të tjera, edhe këto objekte konsiderohen po njësoj. Rrjedhimisht në realitetin shqiptar, në momentin kur jemi dëshmitarë të faktit që mbetjet spitalore përfundojnë në koshat e mbetjeve urbane, kuptojmë se të flasim vetëm për menaxhim të këtyre të fundit devijojmë nga realiteti dhe detyrimisht e trajtojmë atë në mënyrë të fragmentuar.

Gjendja aktuale e menaxhimit të mbetjeve spitalore dhe farmaceutike në Shqipëri është shumë e brishtë dhe përbën një nga shqetësimet më të mëdha në menaxhimin e mbetjeve në tërësi. Ato janë të vendosura pa asnjë lloj kriteri për minimizimin e ndikimit në mjedis, si për sa i përket vendit ku janë vendosur,

---

tipit të ndertimit, si dhe janë pa asnjë lloj shtrese papershkueshmerie dhe mbulimi.

Mbetjet e ngurta urbane aktualisht, vetëm flaken duke zënë sipërfaqe të mëdha toke, ndotin ujrat sipërfaqësore, nëntokësore, ajrin, tokën, duke u bërë problem tepër shqetësues për shëndetin e njerezve të atij komuniteti. Grumbullimi me kriter dhe trajtimi me kriter të mbetjeve të rrezikshme është një domosdoshmëri për gjenjen kritike që ndodhet vëndi ynë.

Subjekti "V.A.L.E. RECYCLING" sh.p.k. me përfaqësues ligjor zotin **Elvis MIRI**, është sipërmarrje private, e themeluar sipas legjislacionit civil shqiptar më datë 29/06/2012, me seli në Lezhë, **NIPT L280299301Q**. Subjekti ushtron veprimtarinë "**Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme, përveç incinerimit ose landfillimit**" në fshatin Gurëz, Komuna Fushë Krujë, rrethi Lac, Qarku Lezhë, në zbatim të Lejes Mjedisore **PN-9488-03-2015**, Kodi III 1.B datë 06.03.2015. Gjithashtu subjekti është paisur me Licensë LN-9339-03-2015, Kodi III.B "Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore". Fokusi kryesor është reduktimi i mbetjeve të rrezikshme. Qëllim është pakësimi i mbetjeve të destinuara për t'u asgjësuar. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme aktualisht realizohet nëpërmjet një sistemi komplet të automatizuar dhe të mbyllur (autoklavë) për sterilizimin dhe grirjen e mbetjeve spitalore, duke e zvogeluar vëllimin e tyre me anë të shperberjes mekanike dhe duke i bërë ato të padëmshme për ambientin me anë të sterilizimit në autoklave.

Nëpërmjet këtij konsultimi me publikun shoqëria kërkon të bëjë present kërkesën për zgjerimin e aktivitetit të saj duke shtuar linjë të re në procesin e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore, farmaceutike (ilaceve të skaduara) si dhe të gomave nëpërmjet procesit të incenerimit si dhe pirolizës.

Është veprimtari që bën pjesë në Menaxhimin e Mbetjeve në ID 5.1 a., 5.3 a. dhe 5.4 a. Me titull të veprimtarisë referuar Shtojcës 1 "Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a) ose landfillimit (5.2 a). Rikuperimi i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R1, R5, R6, R8 ose R9".

Për grumbullimin dhe diferencimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të ngurta urbane, për qëllimet e përcaktuara në planin biznesin e hartuar, shoqëria ka kryer punime ndërtimore, ambiente shtesë si dhe janë instaluar makineri të ndryshme

---

ne të cilat do të kryhen proceset e diferencimit dhe asgjësimit të mbetjeve të ndryshme.

Kjo kërkesë bazohet në Vendimin Nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga qkl-ja", Kreu V "Ndryshime në funksionimin e instalimeve të tipit a dhe të tipit b dhe rishikimi i kushteve të lejeve ekzistuese", Seksioni 1 "Ndryshimi i propozuar në funksionimin e një instalimi të tipit A dhe të tipit B".

Per kete aktivitet shoqëria do të permbushe te gjitha kerkesat e vendosura nga institucionet perkatese si dhe paisja me licensat e domosdoshme.

### **1. KUADRI LIGJOR**

Shqipëria ka legjislacionin e saj të ri mjedisor, të krijuar kryesisht gjatë dekadës së fundit. Ai bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përfshin lloje të ndryshme të akteve normative, si ligje të përgjithshme e të veçanta për mjedisin e për përbërës të tij, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra e udhëzime të ministrive, rregullore specifike, norma e standarde etj. Ky legjislacion është përgjithësisht i përqasur me standardet e BE-së, sepse mbështetet në të njëjtat parime që është mbështetur legjislacioni mjedisor evropian, është hartuar me asistencën e ekspertëve të huaj, si dhe pasqyron përgjithësisht kërkesat e konventave, në të cilat Shqipëria është palë.

- Ligji kuadër Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar. Ky ligj eshte plotesisht i perafruar me Direktiven 2004/35/KE te Parlamentit European dhe Keshillit, date 21 Prill 2004 "Mbi pergjegjesite mjedisore, parandalimin dhe riparimin e demeve te mjedisit" te ndryshuar"
  - Ligji kuadër në fushën e menaxhimit të mbetjeve nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" ndryshuar me ligjin nr. 156 datë 10.10.2013
  - Ligji Nr. 10448, date 14/07/2011 "Per lejet e mjedisit"
  - Ligji nr.9587 datë 20.07.2006 "Për biodiversitetin"
  - Ligji 8906 datë 06.02.2002 "Për zonat e mbrojtura"
  - Ligji nr 9868, datë 04/02/2008, "Për disa ndryshime dhe rregullore të Ligjit për Zonat e Mbrojtura, Nr 8906, datë 06.06.2002".
-

- Ligji nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur"
  - Ligji Nr.9774, date 12/07/2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"
  - Ligji nr.111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
  - Ligji nr.162/2014 "Për mbrojtjen e cilsisë së ajrit në mjedis"
  - Ligji nr.9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik"
  - Ligji nr.10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"
  - Ligji nr. 10, datë 11. 05. 2009 "Për shëndetin publik"
  - Ligji nr.8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave"
  - Ligji nr.9263, datë 29.07.2004 "Mbi ratifikimin e Konventës së NOQ"
  - Ligji nr.9672, datë 26.10.2000 "Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit"
  - Ligji nr.9548, date 01.06.2006 "Për aderimin e RSH në protokollin për rregjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve"
  - VKM nr.178 datë 06.03.2012 "Për incenerimin e mbetjeve"
  - VKM nr.99 datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit të mbetjeve"
  - VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jot ë rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
  - VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorzimit të tyre"
  - VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditsimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
  - VKM nr.267 datë 07.05.2014 "Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore"
  - VKM nr.798, datë 29. 09. 2010 Për aprovimin e rregullores "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore"
  - VKM nr.594 datë 10.09.2014 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"
  - VKM nr.803 datë 04.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësise së ajrit"
  - VKM nr.435 datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkakimeve në ajër në RSH"
-

- VKM nr.692 datë 13.12.2001 "Për masat e vecanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë"
- VKM nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret.e zonimit të mjediseve ujore pritës"
- VKM nr. 1012, datë 10.12.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sinjalistikën në kantier dhe në vendin e punës"
- VKM nr. 418, date 25.06.2014 "Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim"
- VKM Nr 994, datë 2008/07/02, rreth "Opinionit Publik mbi vendimmarrjen mjedisore"
- Rregullore Nr. 6, date 30.11.2007 per Administrimin e Mbetjeve Spitalore.

## **2. QELLIMI DHE KARAKTERISTIKAT FIZIKE TE PROJEKTIT**

Mbetjet dhe trajtimi i tyre:

Mbetjet e rrezikshme apo jo të rrezikshme spitalore, mbetjet farmaceutike të skadura, mbetjet e ngurta urbane mbeten nje problem serioz dhe si te tilla duhet te menaxhohen ne menyren e duhur. Prodhimi i mbetjeve rritet me rritjen e popullsise dhe zhvillimin ekonomik. Nje menaxhim jo i duhur i tyre perben nje rrezik si per shendetin e njerezve ashtu edhe per mjedisin.

Megjithate tashme dihet se menaxhimi i duhur i mbetjeve mbron shendetin e njerezve dhe mjedisin, ndihmon ne mbrojtjen e burimeve natyrore. Objektivi kryesor mbetet reduktimi i sasise se mbetjeve sa me shume qe te jete e mundur si dhe depozitimi dhe trajtimi i tyre ne menyren me ekologjike te mundshme.

Mbetjet spitalore infektive, është një rrymë prioritare mbetjesh dhe menaxhimi i sigurt i mbetjeve nga sëmundjet infektive është i nevojshëm për të minimizuar risqet për shëndetin e punonjësve, pacienteve dhe publikut të gjerë. Janë bërë përpjekje nga Minsitria e Shëndetsisë dhe OBSH për përmirësimin e situatës dhe janë siguruar disa paisje për sterilizimin e mbetjeve nga sëmundjet infektive të prodhuara nga spitalet.

Hapat dhe metodat e kerkuara, zhvillohen sipas nje rendi logjik dhe kronologjik qe prezantohet ne konceptin e menaxhimit te integruar te mbetjeve.

- parandalimi i ndotjes se ujit,
  - parandalimi i ndotjes se ajrit,
  - promovimi i ruajtjes dhe menaxhimit te tokes ne menyre te pergjegjshme, parandalimi i rreziqeve,
-

Tipet e mbetjeve që do të trajtohen përcaktojnë dhe ndotesit potenciale që mund të shfaqen si dhe rrezikun mjedisor të mundshëm në këto rast. Grumbullimi, diferencimi dhe asgjësimi i mbetjeve nga shoqëria "V.A.L.E. RECYCLING" e cila është nën administrimin e z. Elvis MIRI ka për qëllim të minimizohet çdo rrezik për shëndetin publik ose ndotjen e mjedisit nëpërmjet grumbullimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore, farmaceutike etj që prodhohen nga spitalet, klinikat, ambulancat, depot farmaceutike etj dhe asgjësimin e tyre. Mbetjet që grumbullohen veçohen nga diferencimi depozitohen në ambientet e mbylura/hapura të shoqërisë për tu trajtuar më tej me metodën e incinerimit dhe pirolizës. Kjo shoqëri nëpërmjet grumbullimit, diferencimit dhe asgjësimit të mbetjeve ofron:

Kursen energji, menjanon rrjedhjen e lendeve kimike helmuese në atmosferë, ujë, ose tokë, që do të thotë se mjedisi mbetet një vend i pastër dhe më i sigurtë për shëndetin.

Reduktohet volumi i mbetjeve që duhet të trajtohen dhe asgjësohen.

Zvogëlon emetimet e gazeve serë (GHGs).

Harxhohet më pak lëndë djegëse fosile, e më pak dioksid karboni, pasi gjithçka emetohet në atmosferë. Emetimet e ndotësve të tjerë të ajrit mund të reduktohen shumë, duke përdorur teknologji të mira për riciklimin e mbeturinave të rrezikshme.

Përfitimet ekonomike: Riciklimi i mbetjeve të rrezikshme mund të rrisë efikasitetin e prodhimit dhe zvogëlon shpenzimet që lidhen me blerjen e lëndëve të para dhe të menaxhimit të mbeturinave

Biznesi është në gjendje për të eliminuar gjenerimin e mbeturinave të rrezikshme.

Një synim tjetër është të përcaktoje e rekomandoje masat teknike organizative për zbutjen e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Për të realizuar respektimin e mjedisit dhe për të ulur ndikimin e impaktit në mjedis, administratori z. Elvis MIRI, ka bërë një punë të kujdesshme kërkimore, në mënyrë që të mos shkaktojë probleme tek banoret dhe mjedisi përreth, edhe pse vendndodhja është rreth 3km larg zonave të banuara. Gjithashtu janë siguruar metoda dhe pajisje bashkohore për zhvillimin e aktivitetit.

Ky projekt pritet të ketë mjaft aspekte pozitive në;

- Reduktimi i sasisë dhe shkarkimeve toksike të mbetjeve
-



- Reduktimin e vellimit te mbetjeve
- Perfitime ekonomike
- Permiroresim i gjendjes mjedisore.
- Shtim i mundesive te punesimit.

Shoqeria ka nje siperfaqe sheshi ne pronesi te saj brenda te cilit kemi:

- Ambientet e magazinimit
- Ambientet e ndare te tre linjave (autoklava qe eshte ekzistuese, inceneratori dhe piroliza)
- Ambjentet higjeno-sanitare.
- Gdina e administrates

### **3. PROCESET DHE LINJA TEKNOLOGJIKE QE DO TE SHTOHEN NE IMPJANTIN EKZISTUES**

Mbetjet qe do te grumbullohen (lenda e pare):

- **Mbetje spitalore**
- **Mbetje farmaceutike**

**"Mbetje spitalore"** jane mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve, ku perfshihen mbetjet e rrezikshme dhe jo te rrezikshme, te cilat renditen ne paragrafin 18 te vendimit nr.99, date 18.2.2005 te vendimit te K.M. "Per miratimin e Katalogut Shqipetar te Klasifikimit te Mbetjeve".

Mbetjet spitalore prodhohen nga shume subjekte mjekesore, te cilat prodhojne nje sasi te konsiderueshme mbetjesh te rrezikshme. Trajtimi i ketyre mbetjeve ne respektimin e mjedisit eshte nje detyre profesionale dhe etike e tere operatoreve te fushes se mjeksise. Ky trajtim duhet te eliminoje potencialin patogjen qe keto mbetje permbajne, ne menyre qe te reduktohet infektimi i ambjentit, toksiciteti kimik dhe radioaktiv dhe ndotja e pa kontrolluar e mjedisit. Trajtimi dhe transportimi ne menyre te sigurt eshte detyra e te gjithë operatorëve të fushës.

Mbetjet spitalore ne vetvete jane dy lloje: **mbetje spitalore te rrezikshme** dhe **mbetje spitalore te parrezikshme**. Cfar kuptojme me me keto:

"Mbetje spitalore e rrezikshme" perfshin mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretes te infektuar. Mbetjet infektive dhe anatomike perfaqesojne shumicen e mbetjeve te rrezikshme.

---

"Mbetje spitalore e pa rrezikshme" përfshin letrat, sendet prej qelqi, plastike, kartonët, ambalazhet, mbeturinat ushqimore, mbeturina druri dhe ndërtimi, janë mbetjet që prodhohen nga shërbimet e brendshme apo hoteliere.

Mbetje spitalore e rrezikshme përfshijnë kategoritë e mëposhtme:

□ Mbetjet e mprehta \_ janë objektet apo pajisjet që mund të presin apo të futen në lëkurë, p.sh. gjilpërat hipodermike, seti intravenoz ("vigonët"), pipetat Paster, xhama të thyer dhe bisturitë, që janë hequr nga ambalazhimi steril.

Mbetjet laboratorike\_ përfshin të gjitha mostrat e përdorura për testim laboratorik.

Indet njerëzore, materialet ose solucionet që përmbajnë gjak\_ përfshijnë indet, organet, gjymtyrët, gjakun e rrjedhshëm apo të shprehshëm dhe lëngjeve të tjera trupore që janë larguar gjatë operacionit, lindjes dhe autopsisë.

Mbetjet citotoksike\_ janë materialet që janë, ose mund të jenë të ndotura me një bar citotoksik gjatë përgatitjes, transportit ose administrimit të kimioterapisë.

Mbetjet spitalore jo të rrezikshme janë të gjitha mbetjet që nuk klasifikohen në asnjë nga kategoritë e rrymave të mbetjeve spitalore dhe ato të lidhura me to.

Mbetjet e përgjithshme paraqesin shumicën e të gjitha mbetjeve spitalore. Kjo kategori përfshin pecetat higjienike të inkontinencës, mbetjet e kulluara të dializës, mbetjet sanitare dhe pelenat njëpërdorimshe dhe një gamë e gjerë e mbetjeve të zyrës.

**"Mbetje farmaceutike"** përfshijnë produktet farmaceutike të skaduara ose të pa përdorshme, produktet farmaceutike të kontaminuara nga rënia/rrëzimi përtokë, barnat e tepërta, vaksinat ose serumet dhe sendet e hedhura të përdorura gjatë trajtimit të barnave, të tilla si: shishe, kuti, doreza, maska, tuba etj. Ato përfshihen si mbetje spitalore.

Mbetjeve farmaceutike, me përjashtim të citotoksikëve, mund të lindin nga:

- barnat që kanë kaluar kohën e skadencës;
  - barnat e hedhura për shkak të serive jashtë standardi ose ambalazhit të ndotur;
  - barnat e kthyera nga pacientët ose të hedhura nga publiku;
  - barnat që nuk janë më të kërkuara nga institucioni
  - mbetjet e krijuara gjatë prodhimit dhe administrimit të barnave.
-

Proceset teknologjike qe ndjek kompania "V.A.L.E. RECYCLING" sh.p.k, përfshijnë minimizimin/reduktimin në burim, ndarjen, grumbullimin, transportimin, depozitimin, asgjësimin e mbetjeve spitalore dhe farmaceutike nëpërmjet incinerimit dhe pirolizës sipas ketyre hapave :

- a) Peshimi i mjeteve te cilat transportojnë mbetje spitalore dhe farmaceutike, nga institucionet shëndetësore që krijojnë mbetje spitalore, duke përfshirë spitale, poliklinika, qendra shëndetësore, kabinete mjekësore, qendra mjekësore, kabinete dentare, laborator dentarë, qendra diagnostike, depo farmaceutike, farmaci, qendra kozmetike, qendra të tatuazhit, qendra të rehabilitimit nga droga, laboratorët e shëndetit publik, institucionet kërkimore-shkencore, banka e gjakut, shërbimet ambulatorë të infermierisë që vizitojnë pacientë në banesa drejt subjektit "V.A.L.E. RECYCLING" sh.p.k. Çekimi i hyrje-daljeve te ketyre automjeteve, duke i pasqyruar ne sistemin database të kompanise (dokumentat e transferimit te mbetjeve) duke monitoruar situaten.
- b) Stacioni i transferimit të mbetjeve spitalore (magazinimi). Magazinimi që është grumbullimi i përkohshëm, do të bëhet brënda territorit të shoqërisë, në një vend të caktuar të mbetjeve spitalore sipas kërkesave të paragrafit 8.5 të rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore" nr. 708, datë 29.9.2010 e miratuar me VKM. Disa nga kushtet janë magazinimi në kontenierët përkatës të mbetjeve; kontenierët do të vendosen në ambiente të mbyllura dhe të sigurta; do të sigurohet dizinfektimi i mirë i ambientit në rastin e ndotjes aksidentale; do të trajtohen të tëra mbetjet që janë vënë në kontakt me mbetjet mjekësore si mbetje të rrezikshme etj.
- c) Asgjësimi i mbetjes (ndryshimi i vetive ose i përbërjes së mbetjes, duke e transformuar atë në produkt përfundimtar, ose në lëndë të parë apo ndihmëse për prodhimin e produkteve përfundimtare) nëpërmjet procesit të incinerimit apo pirolizës, sipas specifikimi i mbetjes.

Impianti, incinerator mbetje, bazohet në teknologjinë japoneze (është prodhim japonez), që përbëhet nga dy dhomat e djegjes, depozita e vajrave, kutia e kontrollit elektrik, oxhaku në lartësi 9300mm, gjërësi 1300mm si dhe ka një instalim 3D ku mund të shikohet procesi i djegjes. Djegja bëhet me gaz LPG. Ky impiant është një impiant ideal, për trajtimin e mbetjeve spitalore. Bën djegjen/asgjësimin e shumë llojeve të mbetjeve pasi bazohet në procesin e pirolizës.

---

Procesi kryhet me cikël të mbyllur duke shmangur rrezikun nga infeksionet e mundëshme dhe shmang infeksionet dytësore. Është një paisje kompakte që nuk ka nevojë për sipërfaqe të madhe toke. Ky impiant siguron shkarkim të ulët të dioxinave, niveli i hirave është me pak se 5%, voltazhin e ka të rregullueshem që do të thotë se në vartësi të kërkesës ndryshohen ngarkesat. Është një djegje totale nëpërmjet dy dhomave të djegjes në temperatura njëra dhomë 6000 - 9000 dhe tjetra 9000 – 13000 celsius. Njëra dhomë funksionon me ajër, ka kontroll temperature. Fuqia e instaluar është 0.11kë/orë. Kapaciteti trajtimit është 100kg/orë. Mbetjet digjen çdo ditë që do të thotë nuk ka nevojë për kapacitete të mëdha.

Para grumbullimit të mbetjeve bëhet ambalazhimi dhe etiketimi siç duhet i mbetjeve spitalore për të mundësuar identifikimin e lehtë të tyre. Metoda e asgjësimit varet nga përbërja kimike e materialit. Përbërësit duhet të interpretohen/klasifikohen në përputhje me toksicitetin dhe shkallën e ndotjes.

Sikundër u përmënd më lart shoqëria kërkon të shtojë procese teknologjike për asgjësimin e një game më të gjërë të mbetjeve të rrezikëshme spitalore/farmaceutike nëpërmjet procesit të incinerimit dhe pirolizës. Incinerimi është metodë e preferuar trajtimi për kategorinë e mbetjeve: indeve njerëzore, në veçanti për pjesët anatomike të dallueshme, të mbetjeve laboratorike etj. është një zgjedhje ideale dhe me kosto efektive për sasi të ulëta të djegjes së mbeturinave. Sistemi ofron djegjen e mbeturinave shpejtë me normat e konsumit të karburantit të ulët.

Piroliza është metodë e preferuar trajtimi për kategorinë e mbetjeve: mbetje citostike, farmaceutike

I gjithë procesi i transferimit të mbetjeve realizohet nëpërmjet mjeteve të shoqërisë. Automjetet e përdorur për transportin e mbetjeve spitalore kanë karakteristikat e mëposhtme:

Janë të pajisur me pajisje mekanike për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve tranzit me manipulim dhe kontakt minimal të njeriut me koshat/kontenierët;

Sigurojnë mbajtjen e sigurt të koshave/kontenierëve tranzit gjatë udhëtimit dhe mirëmbajtjen e koshave/kontenierëve në një gjendje të mirë dhe sanitare;

Dyer që kyçen, të pajisur me një kit veglash për riparime të vogla, janë kundër derdhjeve dhe mund të pastrohet dhe dezinfektohet higjienikisht;

---

Automjetet që përdoren për të grumbulluar, hequr ose transportuar mbetjet spitalore do të:

mirëmbahen në gjendje të mirë fizike dhe teknike dhe të pastrohen së paku një herë në javë;

pastrohen dhe dezinfektohen tërësisht menjëherë pas çdo derdhje brenda automjetit, ose kur ndoten me ndonjë mbetje spitalore; ndalohen të ngarkohen me ushqime ose produkte farmaceutike apo materiale që kërkojnë kushte të mira sanitare;

ndalohen të ngarkohen me materiale të tjera përveç mbetjeve spitalore nëse nuk pastrohen dhe dezinfektohen më parë tërësisht;

ndalohen të transportojnë çdo mbetje, material ose lëndë tjetër gjatë transportimit të mbetjeve spitalore.

Mbetjet do të vendosen në kontenierin e caktuar për to dhe të etiketuar siç duhet. Mbetjet farmaceutike do të vendosen në enë jo-reaktive.

Mbetjet spitalore do të vendosen në kontenierë që janë kundër rrjedhjeve, të papërshkueshëm ndaj lagështirës dhe të fortë për të parandaluar grisjen apo çarjen në kushte normale përdorimi, do të jenë njëpërdorimsh. Ata do të jenë të tillë që të mbyllen në një mënyrë që mund të parandalojë derdhjen e përmbajtjes gjatë transportit. Kontenierët do të jenë në gjendje të mirë dhe të pa ndotur, të padëmtuar ose ndonjë defekt tjetër, që mund të dëmtojnë përdorimin e tyre të sigurt dhe të siguruar për të siguruar që të mos mbetet asnjë mbetje spitalore në sipërfaqen e jashtme të kontenierëve.

Mbetjet spitalore do të vendosen në llojet e duhura të kontenierëve për të mundësuar identifikimin e lehtë dhe unik të mbetjeve spitalore, që është esenciale për trajtimin e mëvonshëm duhet që ambalazhimi i mbetjeve spitalore të ndjekë kodimin me ngjyra të etiketuar që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë.

Vendi i magazinimit përmbush kërkesat dhe specifikimet e mëposhtme:

- Përdoret vetëm për magazinimin e mbetjeve spitalore;
  - Ka kapacitet të mjaftueshëm për sasinë dhe frekuencën e grumbullimit së mbetjeve;
  - Ka të shfaqur një shenjë paralajmëruese në sipërfaqen e jashtme të strukturës vertikale të vendit në hyrje apo afër saj.
  - Ka mbrojtje të kontenierëve të mbetjeve nga moti (era, shiu/përmbytjet)
-

- Eshtë me mbulesë dhe derë që kyçet për të parandaluar hyrjen e personave të paautorizuar, kafshëve, zogjve dhe për të mos patur infestime të brejtësve dhe insekteve; ka ventilimin dhe ndriçimin e duhur;
- Eshtë vendosur në një zonë të kulluar mirë, të papërshkueshme, të qëndrueshme, të pajisur me pajisje për larje;
- I instaluar larg nga çdo pajisje e ventilimit të godinës;
- I arritshëm nga automjetet e grumbullimit të mbetjeve ku është e mundur;
- Mbetjet spitalore që mund të dekompozohen shpejtë (p.sh. mbetjet që përmbajnë indet e njeriut) do të ruhen në ngrirje për të parandaluar bezdisje të tilla si erë e padurueshme.
- Kur magazinohen mbetje spitalore me lëngje, vendi i magazinimit është i projektuar i tillë që të jetë në gjendje të përmbajë çdo derdhje të lëngjeve. Zona do të pastrohet dhe dezinfektohet menjëherë dhe tërësisht në rast se ndodh ndonjë derdhje e mbetjeve.
- Kontenierët e mbetjeve spitalore nuk do të ngjeshen për të shmangur dëmtimin e ambalazhit të tyre kur vendosen në vendin e magazinimit si dhe do të shmanget sa më shumë të jetë e mundur vendosja mbi njëra tjetrën e qeseve me mbetje spitalore për të shmangur dëmtimin e tyre.
- Asnjë mbetje spitalore nuk do të transferohet nga një kosh/kontenier tranzit në një tjetër gjatë grumbullimit të mbetjeve në rrethana normale.

Stafi i cili drejtohet nga drejtuesi teknik (inxhinier kimist) është kompetent, i trajnuar siç duhet, i mbikqyrur dhe i autorizuar për të kryer këtë detyrë. Gjatë punës do të përdorë veshje të përshtatshme mbrojtëse si doreza, çizme, përparëse dhe maska.

Ambientet do të pastrohen në fund të çdo dite pune dhe të dezinfektohen tërësisht në intervale të rregullta. Në objekt do të instalohet peshorja për peshimin e mjeteve të transportit. E gjithë zona është e rrethuar. Sistemi përbehet nga disa godina ku do të zhvillohen procese dhe trajtime të ndryshme. Ambientet janë të pajisur me energji elektrike, ujë, dhe rrjet kanalizimesh. Ai ka një linjë telefonike, ADSL dhe lidhje interneti. Zona përreth është e vecuar nga zonat e banimit dhe kufizohet me një zonë të gjelbër të pa kultivuar.

---

#### **4. PERSHKRIMI I MJEDISIT EKZISTUESË TE RAJONIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETI**

Proceset që kërkohen të shtohen do të zhvillohen në të njëjtën vendndodhje ku shoqëria zhvillon aktualisht veprimtarinë e asgjësimit të mbetjeve me metodën e autokavës. Kapanoni është i shtruar dhe ka një lartësi që lejon levizjen e automjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për trajtimin e mbetjeve.

Trashegimia arkeologjike dhe kulturore

Qyteti i Lezhës flet për një histori të pasur: monumentet e kulturës, objektet e kultit, monedhat, gjetjet arkeologjike, dokumentat e shkruara, ngjarje e figura të shquara dhe një trashëgimi e madhe kulturore, folklorike, veshje e etnografike etj., janë dëshmi për të kaluarën e qytetit më shumë se 2000 vjeçar . Kjo është pasuri e brezave dhe përbën detyrimin kundrejt të shkuarës e së ardhmes për t'i mbajtur dhe për t'i përcjellë ato me vlerat që mbartin, drejt të ardhmes. Monumentet e kulturës të vizitueshme dhe që mbrohen nga shteti, në Bashkinë e Lezhës, janë 18. Pesë prej tyre: • rrënojat e Akrolisit (Mali i Shelbumit), • rrënojat e qytetit të Lissit, • Kalaja e Lezhës, • vendvarrimi i Skënderbeut dhe • banesa e Esat Mlikës ndodhen në qytetin e Lezhës. Objektet e tjera kulturore dhe historike që përbëjnë interes për t'u vizituar janë Ura e Plakut Gjon (Rraboshtë - 6 km larg), Ura e Shkinës (Piraj - 10.6 km), Banesa e Sali Bajramit (Varosh - 1.3 km), Banesa e Geg Prendit (Patalej - 3.7 km), Banesa e Ndue Frrokut (Ishull-Lezhë - 2.5 km). Me interes për vizitorët janë dhe objektet e kultit si Kisha e Shën Barbullës (Pllanë -10.2 km), Kisha e Shën Aleksandrit (Boikon Spiten - 7.1 km), Kisha e Shën Venerandës (Shën Premtes) (Balldren - 6.7 km), Kisha e Shën Stefanit (Blinisht - 13.3 km), Kisha e Shën Mhillit (Nenshat - 22 km). Parku Arkeologjik i Lezhës, i cili ka një sipërfaqe prej 22 ha, ofron mundësi për të vizituar Akrolissin, Kështjellën e Lezhës, memorialin e Skënderbeut dhe Kishën Françeskane. Kështjella e Lezhës konsiderohet më e madhja në Shqipërinë Qendrore, si dhe simbol i arkitekturës ushtarake të vonë romake, bizantine e osmane. Ajo ndodhet mbi një kodër rreth 305 metra të lartë dhe rreth 80 metra prapa Kishës Françeskane. Në brendësi të kështjellës, vërehen rrënojat e ndërtesave osmane, një xhami garnizoni, si dhe një masiv gëlqeror në qendër. Muret rrethuese që i përkasin periudhës bizantine janë dëmtuar nga osmanët, të cilët i përdorën gurët për ndërtime të tjera. Memoriali i Skënderbeut

---

është ndërtuar mbi kishën e Shën Kollit, ku është varrosur Skënderbeu në vitin 1468. Ky memorial u ndërtua në vitin 1981 për të rikthyer atmosferën e Kuvendit të Lezhës, si dhe për vendvarrimin e Skënderbeut. Për këtë qëllim në brendësi të mureve gjenden një varg mburojash me stemat e fiseve, që morën pjesë në Kuvendin e Lezhës, të cilët bënë besëlidhjen me Skënderbeun. Kisha e Françeskanëve është ndërtuar në vitin 1240, përballë qytetit, në bregun tjetër të Drinit.

Pozita gjeografike, kufijtë

Përbërja e NJQV-ve Qarku Lezhë përbëhet nga pesë bashki dhe 16 komuna, me 9 qytete dhe 170 fshatra, me një popullsi prej 134,027 banorë. Qarku i Lezhës ka një sipërfaqe prej 1,588.4 km<sup>2</sup> dhe kufizohet me Qarkun Shkodër në veri, qarqet Kukës dhe Dibër në verilindje, lindje dhe juglindje, qarkun e Durrësit në jug dhe shtrihet përgjatë bregdetit të Adriatikut në perëndim me një vijë bregdetare prej 38 km. Territori i qarkut të Lezhës përbëhet nga një zonë malore në lindje (65%) dhe zona fushore në perëndim (35%). Shumica e popullsisë jeton në zonat rurale (rreth 60%), ndërsa 40% jetojnë në qendrat urbane.

### ***Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi ekzistues, flora, fauna***

Qarku i Lezhës ka mjaft burime natyrore dhe njerëzore dhe, në veçanti, mjaft mundësi të paeksploruara dhe të pashfrytëzuara për turizmin. Vlerat më të rëndësishme turistike përbëhen nga pasuri historike të shumta, të shoqëruara me pejsazhe të ndryshme natyrore (bregdet, lumenj, ligatina, male, etj.). Pozita e favorshme gjeografike, burimet natyrore turistike dhe klima e përshtatshme bëjnë që turizmi të jetë jo vetëm mundësi, por edhe ardhmja e tij.

Larmia e klimës, topografisë, gjeologjisë, gjeomorfologjisë formon kushte për një larmi habitatesh, flore e faune. Falë daljes në detin Adriatik, rajoni i Lezhës me gjithë territorin e tij të vogël (1462 km<sup>2</sup>) është një vend me të gjitha kushtet për zhvillimin e faunës dhe të florës mjaft të larmishme me një biodiversitet të pasur detar e bregdetar. Në këtë territor, takohen një sërë ekosistemesh si ato detare, bregdetare, lumenj, shkurre mesdhetare përherë të blerta dhe gjetherënëse, pyje gjethegjërë e halorë dhe të përziera, livadhe e kullota, pothuajse të gjitha habitatet që i përkasin vendit tonë si: pyje (pyje gjethegjërë, halorë dhe të përzier, pyje gjysmë natyrorë, pyje të mbjellë), shkurre dhe shkurreta (gjetherënëse dhe gjithnjë të gjelbërta ose makia), sipërfaqe me bimësi barishtore (kullota) dhe kënetore, përrenj dhe lumenj, liqene, rezervuarë, kanale,

---



laguna bregdetare e kënetë të kripura, dunat ranore, grykëderdhjet (deltat lumore), vegjetacioni hidrofil etj.

Përsa i takon faunës, e cila jeton në pyjet brenda territorit të Bashkisë Lezhë, ajo ndahet në 2 pjesë:

- Fauna e lagunave bregdetare
- Fauna e sipërfaqeve pyjore malore

*Fauna e lagunave* është mjaft interesante dhe përbëhet nga gjitarët, peshqit, amfibët dhe reptilët, insektet, molusqet, etj. Janë 11 lloje gjitarësh bioindikatorë. Për sa u përket shpendëve këta përbëjnë një pjesë të konsiderueshme me vlera të faunës së lagunave. Për t'u përmendur janë: Thëllëza e fushës(*Perdix perdix*), Turtulli(*Streptopelia turtur*), Gakthi(*Botaurus Stellaris*), Shqiponja e madhe e rosave(*Aquila clanga*), Shkurta(*Coturnix coturnix*) Pëllumbi i egër(*Columba livia*), Bilbilthi i verdhë(*Acrocephalus pulastris*), Bilbili i kallamave (*Acrocephalus scirpaceus*), Rosa Kryekuqe(*Anas Penelope*), Trishtili i kaltër(*Parus caeruleus*), Rosa marsatore(*Anas crecca*), Bajza (*Fulicaatra*), Pata ballëbardhë(*Anser albifrons*), tepër e rrallë e takuar si dimëruese në këtë lagunë, Çafka e vogël (*Egretta garzetta*), Dallëndyshja e detit (*Glareola pratincola*), Bishtkuqi i mureve (*Phoenicurus phoenicurus*), Pulëbardha e zakonshme(*Larus ridibundus*), Karabullaku i madh(*Phalacrocorax carbo*), Karabullaku i vogël(*Phalacrocorax pygmeus*), Qukapiku(*Dendrocaapus major*), etj.

Në ujërat e lumenjve dhe Lagunës së Kune-Vain kemi një shumëllojshmëri të popullatave të peshqëve ku si më me vlera mund të evidentojmë këto lloje: Krapit (*Cyprinus carpio*), Sharroku (*Perca fluviatilis*), Qefujt (*Mugil cephalus*, Liza ramada, Liza saliens), Ngjala (*Anguila anguila*), Barbuni (*Mulus barbatus*), Gjuhëza (*Solea vulgaris*), Levreku (*Decentrarchus labrax*), Shpalcat (*Sargas sargas*, *Sargas annularis*, *Sargas auratus*), Voqe (*Boops boops*), Lojbe (*Lichia amia*), Shojza (*Solea solea*), Peshk elektrik (*Torpedo torpedo*), Stavridhe (*Trachurus trachurus*), Sepia (*Loligo vulgaris*), Gofa (*Seriola dumerili*), Kavalli i lumit (*Lampetra fluviatilis*), Amja (*Argyrosomus regius*) Tripikaloshi (*Lebistes reticulatus*).

*Fauna e sipërfaqeve pyjore malore.* Shpendët dhe gjitarët, janë elementët më tërheqës dhe më të rëndësishëm në përbërje të biodiversitetit. Në pyjet e Lezhës, rriten dhe strehohen gjitarë e shpendë nën mbrojtje të veçantë. Në kafshët më të rralla dhe që janë me statusin e llojeve të keqësuar apo në rrezik

---

zhdukjeje mund të përmenden: Derri i egër (*Sus scrofa*) dhe Macja e egër (*Felix silvestris*). Por përveç këtyre takohen edhe gjitarë të mëdhenj si: Ujku (*Canis lupus*), Çakalli (*Canis aureus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes faina* Eixl.), Zardafi (*Martes martes* L.), Baldosa (*Meles meles*), Qelbësi (*Mustela putorius* L.), Ketri (*Sciurus vulgaris*), Lepuri i egër (*Lepus Capensis*), Nuselala (*Mustela nivalis*), Lundërza (*Lutra lutra*), Rrëqebulli (*Lynx*), etj. Ndërsa në llojet e rralla të shpendëve që kanë këto statuse dhe që hasen në pyjet e rajonit tonë janë: Thëllënza e fushës (*Perdix perdix*), Kumuria (*Streptopelia decaocto*), Skifteri (*Accipiter nisus*), Gakthi (*Botaurus stelboris*), Shkaba (*Gyps fulvus*), Gjeraqina (*Accipiter gentilis*), Huta me kalca (*Butea lagopus*). Gjithashtu, takohen dhe një sërë zvarranikësh, ku për vlera të veçanta përmendim, nepërkën me brirë (*Vipera amodytes*), Bolla leopard (*Eiaphe situla*), etj.

Flora - Mjediset Pyjore Duke u bazuar në ndarjen e re territoriale dhe në ligjin për administrimin e pyjeve dhe kullotave, rezulton se pjesa më e madhe e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të territorit të Bashkisë Lezhë do të jenë nën administrimin e saj. Jashtë kësaj sipërfaqeje ngelen ato zona të cilat gëzojnë statusin zonë e mbrojtur, zona këto të cilat do të jenë nën administrimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM). Siç dihet, pyjet dhe kullotat janë të shtrira pothuajse në të gjithë territorin e Bashkisë Lezhë, por në masë më të madhe në zonat kodrinore dhe malore. Sipërfaqja e përgjithshme e fondit pyjor dhe kullosor të Bashkisë Lezhë është në rreth 216 km<sup>2</sup>, ku brenda kësaj sipërfaqeje 148 km<sup>2</sup> janë pyje dhe kullota, ndërsa 68 km<sup>2</sup> janë sipërfaqe djerrë dhe tokë inproduktive. Sipërfaqja e përgjithshme e fondit pyjor dhe kullosor shkon në rreth 170 km<sup>2</sup>, ndërsa pjesa tjetër prej 46 km<sup>2</sup> janë shpallur Zona të Mbrojtura. Përsa i takon diversitetit biologjik, mund të thuhet se territori i Bashkisë Lezhë është mjaft i pasur në lloje bimësh dhe drurësh pyjorë që gjejnë kushte të përshtatshme për rritje e zhvillim, që nga bregdeti e deri në lartësinë 1470 m mbi nivelin e detit. Ato janë natyrale dhe të kultivuara.

Biodiversiteti është një nga trashëgimitë më të çmuara të qarkut të Lezhës.

Në vijën bregdetare prej 38 km të qarkut të Lezhës ku gjenden zonat e mbrojtuar Kune – Vain e Patok, mbetet ndër më inetresantet e vendit tonë. Habitatet karakteristike të këtij bregdeti janë: dunat ranore, ligatina bregdetare, lagunat, pyjet halore mesdhetare, pyjet aluvionale bregdetare.

---

Dunat ranore Sistemi i dunave ranore, në bregdetin e qarkut Lezhë, është i zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme veçnisht në të dy anët e grykëderdhjes së lumit Drin. Në përgjithësi, ky sistem është i ruajtur mirë në kushtet natyrore. Por nga ana tjetër, aktiviteti njerëzor nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës, urbanizimit dhe turizmit përfaqëson një kërcënim të përhershëm dhe në rritje për ekosistemet e plazheve dhe dunave ranore. Mbi të gjitha, vija bregdetare e rajonit është e kërcënuar në mënyrë serioze nga erozioni, i cili llogaritet në disa raste deri 2.5 m marrje e tokës nga deti, si pasojë e pakësimit të inerteve lumore të sjella nga lumenjtë Drin e Mat. Ligatinat bregdetare. Kanë një shtrirje të konsiderueshme dhe janë të mirëprezantuara në deltën e lumit Drin e Mat. Vegjetacioni i këtyre mjediseve, për vetë kushtet e ashpra të rritjes (kripshmëri shumë e lartë dhe përmytje të herëpashershme), paraqitet shumë i mirë, i ruajtur në krahasim me tipet e tjera të bimësisë të rajonit bregdetar.

Lagunat në zonat e ndryshme të bregdetit të Adriatikut, kanë nivele të ndryshme të trofisë, të vlerësuara nga sasia e klorofilit A në fitoplankton.

Pyjet përbëjnë një element mjedisor me vlera. Pyjet natyrorë aluvionalë të bregdetit shqiptar përfaqësojnë pyje tipikë higrofilë, të përhapur kryesisht në grykëderdhjet e lumenjve Mat dhe Drin, mbi toka aluvionale kryesisht bazike, me nivel të lartë të ujërave nëntokësore dhe të përmytura shpesh nga vërshimet apo shirat e rrëmbyeshëm. Pyjet e dikurshëm, në këto zona, kanë pamjen e shkurretave, kthimi i të cilave në gjendjen e mëparshme mund të kërkojë një periudhë 10-15 vjeçare. Kushtet e vecanta të përhapjes së këtyre pyjeve (toka aluvionale me nivel të lartë të ujërave nëntokësore dhe që përmyten kohë pas kohe), në përgjithësi nuk lejojnë vendosjen e llojeve të tjera apo konkurrencën e tyre ndaj llojeve autoktone.

Fauna e lagunave përbëhet nga 32 lloje shpendë të ujit dimërues dhe folezues në lagunat bregdetare shqiptare. Në zonat lagunore janë 10 lloje amfibësh e 29 lloje reptilësh si dhe breshkave të tokës (*Testudo hermanni*), breshkave të detit *Caretta caretta*, foka e Mesdheut *Monachus monachus*, shigjetës së gjatë (*Coluber caspius*), shigjetës së shkurtër (*Coluber gemonensis*), bollës së shtëpisë (*Elaphe longissima*). Pothuajse në të gjithë zonën malore takohet ujku (*Canis lupus*), dhe në malin e Skënderbeut takohet një tjetër gjitar i madh, ariu (*Ursus arctos*), Vihet re dhe prania e insektit *Thaumetopoea pityocampa* (proçesionaria e pishës) apo të *Hypantiria cunea*

---

Qarku i Lezhës është një rajon, ekonomia e të cilit dominohet nga prodhimi bujqësor. Degradimi i tokës bujqësore nga gërryerjet dhe përmytjet mbetet problemi më serioz.

Pellgu i Lezhës përfshin zonën Shëngjin-Zadrimë-Bregu i Matit dhe furnizon me ujë të pijshëm qytetin e Lezhës dhe Shëngjinit, si edhe të gjithë fshatrat e fushës. Sasia e ujit të shfrytëzuar prej tij, përfshi edhe ujin teknologjik është 400 l/sek. Ujësjiellësit kryesorë janë ai i Barbullojës dhe i Rrillës. Zona e ushqimit është kryesisht bregu i lumit Mat në jug. Rezervat ujore të llogaritura janë rreth 2000L/sek. Pellgu përfshihet në depozitimet ujëmbledhëse zhavorrore me trashësi që rritet në drejtim të lumit Mat deri në 180-200 m. Ato janë të mbuluar me një mbulesë argjilore dhe subargjilore me trashësi 45-50 m. Zona e ushqimit është kryesisht bregu i lumit Mat në jug. Rreziku i ndotjes sipërfaqësore është i ulët falë mbulesës së trashë ekranizuese, largësisë së zonës së ushqimit dhe karakterit artesian të shtresave ujëmbajtëse. Vetëm shpeshtimi i shfrytëzimit mund të nxisë depërtimin e ujërave me mineralizim të lartë nga krahu verior e perëndimor i pellgut ujëmbajtës. Nga rezultatet e monitorimit duket se ujërat nëntokësore të këtij pellgu janë dy llojesh: ujëra me fortësi të vogël e mineralizim të ulët dhe ujëra me mineralizim të lartë. Lloji i parë takohet në Barbullojë. Vihet re një niveoicakuar i NO<sub>2</sub> në Barbullojë dhe Hotelin e Gjuetisë. Nga analizat, vërehet se ka rritje graduale të mineralizimit të përgjithshëm të Na (Natriumit) dhe Cl (Klorit). Analizat e kryera për mikroelemente rezultojnë pa përmbajtje të tyre.

Ujrat nëntokësore të pellgut të Lezhës kanë veti fiziko-kimike të mira. Shfaqja e përmbajtjes së NO<sub>2</sub> lidhet me kushtet higjenosanitare rreth stacioneve të pompimit. Pellgu i Fushë-Kuqes (Laçit) Kufiri verior i këtij pellgu është lumi Mat ndërsa ai jugor është lumi i Drojës. Në perëndim kufizohet me vijën bregdetare të Adriatikut, deri në derdhjen e lumit Mat, ndërsa në lindje me vargun e kodrave të Mamurrasit deri në Milot. Pellgu i Fushë- Kuqes përfaqësohet nga kompleksi ujëmbajtës, depozitimet aluviale të ndërtuar nga disa shtresa horizontale ujëmbajtëse me trashësi 30-40m. Mbulesa subargjilore dhe vende-vende subranore dhe ranore, fillon nga niveli 0m në lindje, në fushën e Milotit dhe arrin deri në 30m në drejtim të perëndimit, ndërkohë që në zonën e derdhjes së lumit Mat, dyshemeja e zhavorreve mendohet të zhytet deri në thellësinë 200m. Ky pellg është pellgu ujëmbajtës me shfrytëzim më të lartë në Shqipëri.

---

## **Klima**

Qarku Lezhe përfshihet në nënzonën Klimatike Mesdhetare Fushore Qendrore. Në këtë nën zonë reshjet vjetore kanë vlera që lëkunden ndërmjet 950-1200 mm.

Temperaturat minimale absolute marrin vlera nga -3 deri -5 °C; vetëm në raste shumë të rralla mund të vrojtohen temperatura më të ulëta se këto vlera. Periudha e ngricave është shumë e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrica mund të marrë vlera nga 12 deri 15 në vit, gjatë të cilave vlera e temperaturës minimale mund të bjerë nën 0°C.

Erërat, në përgjithësi fryjnë nga dy drejtime. Gjatë stinës së ftohtë mbizotërojnë erërat nga juglindja pa përjashtuar veriun ndërsa gjatë periudhës së ngrohtë mbizotëron veriperëndimi. Shpejtësitë maksimale të erës në këtë zonë gjatë stinës së ngrohtë marrin vlera nga 10 deri 15 m/s dhe gjatë stinës së ftohtë prej 25 deri 30m/s.

Diellezimi Vlerat maksimale të diellzimit vrojtohen në muajin Korrik ndërsa ato më të ulta në Dhjetor. Vlera mesatare vjetore e diellzimit është 2613 orë, vlerë kjo mjaft e lartë për rajonin tonë. Ky nivel i lartë i diellzimit dhe klima tipike mesdhetare përbën për Bashkinë Lezhë një potencial shumë të vlefshëm. Duke filluar nga aspektet shëndetsore kjo klimë është një vlerë e shtuar e zonës edhe për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, blegtorisë dhe turizmit.

Temperatura e ajrit Temperatura e ajrit është një element i rëndësishëm klimatik i cili shpreh madhësinë e energjisë diellore në afërsi të tokës. Vlerat më të larta të temperaturës mesatare mujore arrihen në Korrik(23.4°C) dhe vlera më ulët në muajin Janar(6.5°C). Vlera mesatare vjetore është 14.9°C. Temperaturat minimale absolute marrin vlera nga -3 deri -5°C; vetëm në raste shumë të rralla mund të vrojtohen temperatura më të ulta se këto vlera. Periudha e ngricave është shumë e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrica mund të marrë vlera nga 12 deri 15 në vit, gjatë të cilave vlera e temperaturës minimale mund të bjerë nën 0°C. Për sa i përket temperaturave maksimale absolute vlerat e tyre rrallë herë e kalojnë vlerën 35-36°C. Vlera më e lartë e temperaturës maksimale absolute është 39<sup>0</sup> C. Lezha karakterizohet nga një klimë e butë e tipit mesdhetar për shkak të pozitës gjeografike me dalje të gjerë në det dhe me relief në përgjithësi të ulët në shumicën e njësive administrative.

---

Reshjet atmosferike janë një element tjetër klimatik i rëndësishëm. Vlerat mesatare më të larta arrihen në muajt e dimrit ndërsa më të ulta në muajin Korrik. Sasia mesatare e reshjeve vjetore ka vlerën 1299 mm. Numri i ditëve me reshje më të mëdha se 0.1 mm lëkundet ndërmjet 85 dhe 100 ditëve. Në këtë zonë reshjet maksimale shpesh herë bien në fomë rrebeshi. Bora është një dukuri dhe një shtresë bore e qëndrueshme nuk vërohet në këtë zonë. Shtresa maksimale e borës arin vlerën 5 - 10 cm dhe shumë rrallë 15-17cm, dhe këto të paqëndrueshme.

Lagështia e ajrit është gjithashtu një element i rëndësishëm klimatik për t'u marrë në considerate, vlerat më të larta të lagështisë relative të ajrit vërohen në muajt e dimrit (79-80-%), ndërsa vlerat minimale në stinën e verës (63- 67%).

#### Hidrografia dhe hidrogeologjia

Bashkia e Lezhës kufizohet nga jugu e jugperëndimi nga Laçi, Fushë Kuqja dhe Patoku, vazhdon me Gjirin e Drinit e Malin e Rencit në perëndim e veriperëndim, me Shpal, Hebje e Xhuxhë në veri dhe Urakë e Kurbnesh në Lindje. Hidrografia e zonës në studim përbëhet prej ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore që gjenden në akuiferët kryesorë të zonës në studim. Territori i Bashkisë Lezhë, është i pasur me rezerva ujore nëntokësore e sipërfaqësore. Përveç detit Adriatik, haset një pasuri e konsiderueshme me liqene (rezervuarë) artificialë, lumenj, burime termale kuruese, etj.

#### Ujërat sipërfaqësore

Rrjeti hidrografik i Bashkisë së Lezhës përbëhet prej disa lumenjve, ku ndër më kryesorët janë Lumi i Matit, që kufizon Bashkinë e Lezhës nga Bashkia e Kurbinit, Drini i Lezhës, që vjen nga Veriu dhe pasi kalon pranë qytetit të Lezhës derdhet në Detin Adriatik në Gjirin e Drinit. Lumenj të tjerë më pak të rëndësishëm janë lumenjtë Gjadër, që ndodhet në veri të Lezhës dhe lëviz në drejtim Lindje - Perëndim, Fani Madh dhe Fani i Vogël që rrjedhin nga Veriu (Qafa e Malit, Pukë) dhe verilindja (Domgjon, Mirditë), takohen me njëri tjetrin afër Rubikut dhe së bashku derdhen në Lumin Mat. Ky i fundit është lumi më i rëndësishëm për furnizimin me ujëra nëntokësore të akuiferëve të Lezhës dhe Fushë - Kuqes. Lumi Drin është lumi më i gjatë i Republikës së Shqipërisë, 283 km. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 5817km<sup>2</sup>, prurjet mesatare vjetore 280 m<sup>3</sup>/sek. Në shtratin e lumit Drin është ngritur kaskada më e madhe në Shqipëri me tre hidrocentrale Lumi Drin ka dy degë kryesore: Drini i Bardhë dhe

---

Drini i Zi. Drini i Lezhës fillon në afërsi të fshatit Mjedë të rrethit të Shkodrës, bashkohet me ujrat e lumit Gjadër, kalon përbri qytetit të Lezhës dhe derdhet në detin Adriatik. Lumi i Mat Ky lum ka një gjatësi prej 144 km dhe një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 2441km<sup>2</sup>. Gjerësia e shtratit afër Milotit është rreth 1250m, ndërsa në grykëderdhje 1000- 1200m, prurja mesatare vjetore në Lumin Mat ndryshon nga 85 deri 103 m<sup>3</sup>/s.

Lumi Gjadër buron nga lartësitë e Tërbunit të Pukës dhe ka një gjatësi prej 40,5 km. Rrethin e Lezhës e përshkon në 10 km gjatësi. Ka një pellg rreth 120 km<sup>2</sup> dhe prurje mesatare vjetore 8.8 m<sup>3</sup>/sek. Përveç këtyre, mund të përmendim edhe disa përrenj si : Përroi i Lushisë dhe i Qershisë në zonën administrative të Kallmetit; Përroi i Troshanit në zonën administrative Blinisht; Përroi i Manatisë në zonën administrative Kolsh.

Liqenet (rezervuarët) artificialë Bashkia e Lezhës është mjaft e pasur edhe me liqene (rezervuarë) artificialë, të cilët grumbullojnë ujin e përrenjve dhe lumenjve për t'i shfrytëzuar më pas për ujitjen e kulturave bujqësore gjatë periudhës së verës. Këta rezervuarë janë të shpërndarë pothuajse në të gjithë njësitë administrative.

#### Ujërat nëntokësorë

Ujërat nëntokësorë në territorin e Bashkisë Lezhë ndodhen kryesisht në zhavorret ujëmbajtëse të akuiferit të Lezhës, Fushë-Kuqe. Shfrytëzimi intensiv i këtij akuiferi ka filluar që në vitin 1964 me kryerjen e një sërë shpimesh me rrotullim dhe me goditje në zonën e Fushë Kuqes dhe Adriatikut. Pas vitit 1966 hynë në shfrytëzim edhe shpimet e Milotit nga ku merren rreth 460 l/s.. Në këtë mënyrë vetëm nga akuiferi i Lezhës merren rreth 1300 l/s. Përveç sasisë së ujërave nëntokësorë që merren si në krahun verior të Lumit Mat ashtu dhe në krahun jugor të zonës, tjetër zonë në perspektivë për marrjen e burimeve ujore suplementare është edhe grykëderdhja e vetë Lumit Mat. Kjo pjesë kufizohet nga Rrila e Planës në veri të Lumit Mat dhe që vazhdon me Gurrzën, Fushë-Milotin dhe vetë zallishten e Lumit Mat, përbën zonën më perspektive të pellgut të Matit. Shpimet e kryera në këtë zonë kanë kapur zhavorre me trashësi mbi 100mm, të cilat formojnë një shtresë ujëmbajtëse me parametra hidraulike shumë të lartë dhe me cilësi uji shumë të mirë. Bazuar në llogaritjet e bëra në këtë zonë mund të merren rreth 2500 l/s ujë, pa ndikuar në regjimin e akuiferëve të tjerë.

---

## Akuiferi i Lezhës

Ky akuifer fillon nga bregu i djathtë i Lumit Mat dhe vazhdon deri tek Hoteli i Gjetisë. Në afërsi të shtratit të lumit Mat trashësia e zhavorreve arrin deri në 175m, ndërsa më në veri kjo trashësi është më e vogël. Trashësia e zhavorreve në pjesën lindore të rajonit zvogëlohet deri në pykëzimin e tyre dhe në ndonjë rast, si në Manati, ato kontaktojnë direkt me shkëmbinjtë rrënjësore. Në pjesën verilindore të Ishullit të Shëngjinit zhavorret kontaktojnë me gëlqerorët e strukturës antiklinale të Rencit. Në dalje të Lumit Mat nga lugina e thellë erozionale (mbas grykës së Shkopetit), zhavorret e ujëmbajtëse të tij në Milot dalin mbi sipërfaqe dhe duke shkuar drejt perëndimit, veriperëndimit dhe veriut zhyten në mbulesën suargjillore-suratore dhe ranore, duke formuar shtresat ujëmbajtëse zhavorore me presion. Në afërsi të rrjedhës së Lumit Mat mbulesa pothuaj mungon fare ose ka trashësi më pak se 2- 3m ndërsa në veriperëndim të fushës së Lezhës rritet deri 62-64m. Në akuiferin e Lezhës zhavorret në afërsi të lumit kanë trashësinë maksimale që shkon mbi 175m, ndërsa duke u larguar nga shtrati në drejtim veriperëndimor, brenda zhavorreve, në intervale të ndryshme shfaqen suargjilat.

Gjeologjia inxhinierike Formacionet litologjike, inkuadrimi gjeologjik i tyre.

Territori i Bashkisë Lezhë ndërtohet nga shkëmbinj dhe dhera të moshave gjeologjike nga Triasiku deri në Kuarternar që i përkasin zonës tektono faciale "Mirdita", Nenzonës "Krasta", zonës "Kruja" dhe "Ultësirës Pranë Adriatike"(UPA). Në këtë klasifikim shkëmbinjtë ndahen në tre grupe: shkëmbinj të fortë; shkëmbinj mesatare; shkëmbinj të butë. Kriteri i ndarjes së tyre është rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh). Ndërsa dherat janë klasifikuar në tre grupe:

- dhera pa lidhje kohezionale
- dhera me lidhje kohezionale
- dhera me veti të veçanta

Kriteret e ndarjes së dherave, janë:

kohezioni (c), (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse) dhe këndi i fërkimit të brendshëm ( $\varphi$ ).

Më poshtë për secilën kategori (të shkëmbinjeve dhe dhereve) është bërë një përshkrim i shkurtër mbi pozicionin e tyre në lidhje me zonat tektoniko – faciale të përmendura më sipër dhe karakteristikat bazë fiziko mekanike.

---



Shkëmbinjë e fortë. Rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh) >500 bar. Në hartë janë paraqitur me ngjyrë të kuqe.

Në këtë grup hyjnë : Gëlqeroret (G). Gjejnë përhapje në zonat tektoniko - faciale "Mirdita", N/z. "Krasta" dhe zona "Kruja" nga Triasiku i mesëm deri Eocen.

Në zonën "Mirdita" takohen: depozitimet karbonatike(T3 - J1), ato të Cr1 e Cr2. Depozitimet (T3 - J1) përhapen në perëndim të Rubikut, në Velën e Vendit-Qafe-Kinxhël. Janë facie gëlqerorësh neritike alqorë, shtresë trashë deri masivë, kryesisht ngjyrë gri, gri të bardhë. Në Lisnë e Spitën në kreun e prerjes, mbi gëlqeroret me megalodonte takohet një pako 30-50 m e trashë e gëlqerorëve biomikritike krinoidale, shtresë mesëm, hiri dhe rozë, që përmbajnë dhe mjaft foraminifere.

Gëlqerorët e Cr1 e Cr2 përhapen në sektorët lindore nga Lufajt deri në Xhuxhë dhe ndërtojnë kuotat më të larta të relievit si Mali i Valmorit, Mali i Shenjtit, Maja e Zebës etj. Janë gëlqerorë shtresëhollë - trashë deri masivë. Në sipërfaqe janë të copëtuar e me çarje në trajtë blloqesh. Fenomeni i karstit është shumë i përhapur në to, në sipërfaqe vërehen hinka e gropa karstike, ndërsa përgjate shpateve të thepisura të tyre takohen shpella karstike.

Në N/zonën "Krasta" depozitimet e Kretakut të sipërm (Cr2) përhapen në trajtën e dy pakove gëlqerore: ajo e poshtëme kryesisht pelitomorfe shtresë trashë dhe e sipërme shtrese hollë. Janë me ngjyrë gri, gri të çelët në rozë, me trashësi 45 - 50 cm. Takohen në lindje të Raboshtes (m. Mërqies), Manati, (m. Fecores), Pllanë, Milot, Mali i Shëngjergjit.

Në zonën "Kruja" përfaqësohen nga depozitimet e Kretakut të sipërm (Cr2) dhe të Eocenit (Pg2). Depozitimet e (Cr2) takohen veriperëndim të territorit, në malin e Kakarriqit dhe atë të Rencit, në jug në afërsi të Mamurrasit dhe në lindje të Laçit (në formën e një brezi nga Miloti deri në lindje të Mamurrasit). Përfaqësohen nga gëlqerorë, gëlqerorë të dolomitizuar dhe dolomite të mirefillta. Depozitimet karbonatike të Eocenit (Pg2). Shtrihen në formën e një brezi që markon gëlqerorët e Kretakut të sipërm, në verilindje të kurrizores së Rencit, në të dy krahët e kurrizores së Kakarriqit dhe në lindje të Mamurrasit. Ndërtohen nga dy pako gëlqerorësh: pakoja e gëlqerorëve miliolidike dhe pakoja e gëlqerorëve me numulites e diskociklina.

Gëlqerorët silicore (Gsi). Gjejnë përhapje në zonën tektono - faciale "Mirdita" dhe N/zonën "Krasta". Në zonën "Mirdita" përfaqësohen nga seria karbonato-silicore

---

(T2) gëlqerorë të kuq nyjorë, gëlqerorë pllakorë me silicorë. Takohen në trajtë bllokore nga përroji i Katundit të vjetër deri në majën e Drenit dhe në Ferr-Shkopet. Në N/zonën "Krasta" përfaqësohen nga depozitimet karbonatike Jurasike (J), gëlqerorë masive kristalinë e pelitomor ngjyrë gri e deri në rozë të çelur. Janë shkëmbinj mikritikë me damarë kalciti dhe me stiliotite. Trashësia e tyre shkon 25-30 m. Takohen në daljen e Spitën Zejmenit.

Formacioni ofiolitik i Mirditës (J2), ku marrin pjesë: shkëmbinjte intruzivë magmatikë ultrabazikë (Iu), shkëmbinjte magmatikë bazikë (Ib), shkëmbinjte magmatikë mesataroacidë (I<sub>ma</sub>), shkëmbinjte efuzivë magmatikë bazikë (Eb), shkëmbinjte efuzivë magmatikë mesataroacidë (E<sub>ma</sub>). Skaj më perëndimor i përhapjes së ofioliteve është nga Krajani(m. Pilinardes) , maja e Potit, Reja e Velës, Qafë Sul, Fang deri ne Ferr- Shkopet, ndërsa në lindje nga Thirra (m. e Runës) në Përlat i Epër dhe përrojin e Urakës në veri të fshatit Prell. Shkëmbinjte metamorfike rreshpore (R<sub>m</sub>). Përfaqësohen nga shtroja metamorfike (μJ2) (amfibolite, paragnejse, rreshpe kuarc-mikore). Kanë përhapje mjaft të kufizuar në trajtën e daljeve të vogla në kontaktin e serisë efuzivo sedimentare me shkëmbinjte ultrabazikë e më pak me pakon argjilite me copa. Takohen në zonën ndërmjet Kallmetit të Madh dhe Fregën si dhe në veri të Rejës së Velës.

Shkëmbinjte mesatare. Rsh 50 - 500 bar. Në hartë ngjyrosen me ngjyrë manushaqe. Shkëmbinjte flishore dhe ato me pamje flishore (FI) në zonën "Mirdita" përfaqësohen nga Melanzhi Mirdita "blloqe në matriks" (J3), depozitimet terrigjeno karbonatike të flishit të hershëm (J3t - Cr1v). Melanzhi Mirdita "blloqe në matriks" është njësi litostratigrafike me përbërje mjaft heterogjene. Zhvillohet thuasë në të gjithë rajonin duke mbushur depresionet erozionalo-tektonike nga Fangu - Qafë- Munaz - Velë - Qafë - Kinxhël, Gëziq-Shtanë - Rreshen, Tarazh-Perlat i Epër -Lëkundë-Bardhaj, Malaj - Kullaxhi- Blinisht, Kodër Spaç, Gurth-Mushtë, Simon etj. Ndërtohet nga rreshpe argjilitesh, argjilo silicore si dhe copra apo blloqe gëlqerorësh, ofikalcitesh, ranorësh, ofiolitesh (vullkanitesh ) etj. Matriksi argjilor ka ngjyrë gri, gri të gjelbër, gri të errët. Copat përfaqësohen kryesisht nga ranorë arkozike, grauvake, silicorë radiolaritikë dhe bazalte.

Në depozitimet e flishit të hershëm (J3t - Cr1v) veçohen dy trashësi litofaciale: a - konglobrekçiet ofiolitike dhe b - flishi i hershëm në bashkëshoqërim në përhapje dhe ekuivalence moshore me njëra tjetrën:

---

a - konglobrekçiet ofiolitike përhapen në Kurbnesh (Kumbull, Bisakë, Xhuxhë, Munellë) etj, në përbërje të tyre mbizotërojnë përbërësit ofiolitike. Përveç tyre takohen edhe copra e thjerza silicori radiolaritik, gëlqerorë biomikritik etj.

b - flishi i hershëm përhapet në Katundin e Vjetër, Derven, Kurbnesh dhe dalje më të kufizuara takohen në Tarazh dhe Perlat (Lekgegaj ). Ai ndërtohet nga ndërshtresa mergelore, reshpe argjilo silicore, gëlqerorë e konglomerate.

N/ zona Krasta përfaqësohet nga depozitimet flishore të aptian-albianit (Cr1), (Pg1-2), (Cr2m) dhe (Cr2m-Pg1-2).

Depozitimet flishore të aptian-albianit (Cr1) takohen me dy pako: paketa e flishit gri alevrolito - mergelore - gëlqerorë - ranorë dhe paketa e flishit të kuq alevrolito - mergelore. E para përbëhet nga gëlqerorë pllakorë, mergele alevrolite e ranorë kompakt. Flishi me ngjyrë të kuqe përfaqësohet nga një ndërthurje ritëmholle alevrolito-mergelore - gëlqerore. Takohet në rajonin Fang - Katund i Vjetër. Depozitimet flishore të (Cr2m), në pjesën e poshtme përfaqësohen nga ndërthurje gëlqerorësh mikritikë, kristalikë e rrallë copëzorë, mergelesh, alevrolitesh, rrallë ranorë, më lart prerja bëhet ranoro - alevrolitore me shtresa mergelesh, me ndonjë shtresë të rrallë gëlqerori. Trashësia, disa metra deri 15 - 20 m. Takohen në Kallmet, Manati, Zejmen, Bërzanë, Milot, Selitë deri në Mafsheq, gjithkund në kontakt me depozitimet e (Pg1-2). Depozitimet flishore të (Cr2m-Pg1-2), janë kryesisht ndërthurje flishore alevrolite-ranore me horizonte vithithëse konglomeratike. Këto të fundit kanë ndërtim të çrregullt ku masa kryesore përbëhet nga alevrolite e ranorë. Formacionet e kësaj nënzone takohen në pjesën jugperëndimore e perëndimore të Mirditës nga Vinjolli, Gallata, Skuraj, Rrasfiku, Katundi i Vjetër e Kallmeti në veriperëndim. Depozitimet flishore të Paleocen-Eocenit (Pg1-2) përfaqësojnë një trashësi flishore potente me ndërthurje alevrolitesh e ranorësh midis të cilave gjenden horizonte vithithëse me olistolite e konglomerate. Mergelet janë të rralla në prerje e kanë natyrë linzore e rrallë shtresore, ngjyrë rozë dhe thyerje karakteristike guackore. Gëlqerorët copëzorë janë të rrallë dhe paraqiten mjaft kompakt të ndërtuara nga copra karbonatesh me madhësi të ndryshme e matriks të së njëjtës përbërje. Horizontet vithithëse kanë ndryshim litologjik gjatë shtrirjes (ndërtim të çrregullt), ku masa kryesore është alevrolito - ranorike. Në nivelet më të sipërme të prerjes gjenden horizonte potente konglomeratesh. Takohen nga Fishta në veri e deri në Mafsheq në jug, në trajtën e një brezi me gjerësi mbi 2 km në zonën qendrore të

---

perhapjes (Rrasfik Skuraj) dhe me ngushtime drejt Fishtës e Mafsheqit. Në zonën "Kruja" përfaqësohen nga depozitimet flishore të Olgocenit të Poshtëm (Pg31). Depozitimet flishore (Pg31) , në zonën e studimit përfaqësohen me dy pako:

Paketa e flishit ranoro - argjilor (Pg31b) ndërthurje ranorësh shtresëtrashë deri në masivë gravelitikë me ndërshtresa argjilore Paketa argjilore me ndërshtresa të ralla ranore (Pg31c) Ajo përbën bërthamën e strukturës sinklinale të "Krujës". Ato përhapen në pjesën veriperëndimore, në afërsi të ranës së hedhur, në jugperëndim të kurrizores së Rencit dhe pranë fshatit Torovicë. Në zonën e Milot - Laç Mamurrasit, këto depozitime takohen në dy breza : brezi lindor shtrihet në jug të Malit të Bardhë, Delbnisht (Kamera), Lester, Mafsheq (Shezë) deri në përrojin e Grykë Shkozës ; brezi perëndimor shtrihet nga Laçi, Gjomëni, Shëmria deri në afërsi të lumit të Drojës (Picragë), (Lamaj M etj.2009). Seria efuzivo - sedimentare (Es) përfaqësohet nga depozitimet e (T2-J1) në zonën "Mirdita", ku bazaltet janë përfaqësuesit kryesorë të trashësise vullkanogjene, më pak ndeshen hialobazaltet e variolitet. Brenda kësaj trashësie zhvillohen rreshpet argjilore, argjilo-silcore, tufet, radiolaritet, gëlqerorët biomikritik e linza ranorësh. Shtrihen nga Munazi, Rubiku ,Vela e më në veri deri në Qaf - Kingjël, në veri të Rrejës - Fregën- Rrasi i butë. Mollasa argjilore (Ma) këtu përfshihen formacionet e zonës "Kruja" me depozitimet e Piocenit, suita "Helmësi"(N21h). Depozitimet e kësaj suite përfaqësohen në prerje nga ndërthurje ranorësh gravelitikë me ranoro - alevrolitorë dhe më sipër vendosen alevrolito - argjilat tipike të kësaj suite me ngjyrë të kaltër e masive. Brënda zonës sonë të studimit kanë trashësi deri 40 m (Shullaz). Kanë përhapje të kufizuar. Ndeshen në vendin e quajtur kodra e Shullazit dhe në perëndim (Laç - Gurra), në kodrat e Mamurrasit, në Shpërdhet dhe kordat përreth. Mbivendosen në menyrë transgresive mbi gëlqerorët e Kretakut të sipërm dhe fliшин Kruja (Lamaj M etj.2009). Mollasat ranoro-konglomeratike (Mrk), përfshihen depozitimet Mollasike të Tortonianit (N13), të Pliocenit (N2), e ato të Pliocen - Pleistocenit (N2 - Qp). Depozitimet mollasike të (N13). Në bazament takohen konglomeratët bazalë kokërr trashë që zbulohen në sipërfaqe me trashësi deri 20 m. Coprat konglomeratike janë të përbërjes gëlqerore, ranore dhe magmatike. Duke ja lënë vendin më sipër në prerje konglomerateve më kokërrimët deri sa kalohet kuarcorë kokër imët deri kokër mesëm. Kjo prerje e depozitimeve Tortoniane në kodrën e Kullës arrin

---

trashësinë deri 60 m. Vazhdimi në shtrirje e rënie nuk vërehet për arsye të proçeseve erozive - denuduese, dhe akoma më në perëndim është e mbuluar nga depozitimet mbulesore të Kuaternarit. Në sipërfaqe dalin në formë pulle transgresive në vendin e quajtur kodra e Kullës në lindje të ish kombinatit Kimiko – metalugjik (Laç), në Selitë (Kuqni) në kontaktin e depozitimeve karbonatike të Cr2 me flishin e Oligocenit (Pg31). Depozitimet mollasike të Pliocenit (N2). Përfaqësojnë vazhdimin VP depozitimeve të gropës së Burrelit (pjesa e sipërme e prerjes). Vendosen transgresivisht mbi melanzhin "bllaqe në matriks" dhe përfaqësohen nga ndërthurje ranorësh me argjila e ndërshtresa konglomeratesh. Kanë trajtë shtresore-linzore me rënie të butë deri 200 dhe karakterizohen nga ndryshime faciale. Përbërësit copëzore janë copa gabrosh, ultrabazikësh, vullkanitesh, kuarcitesh, gëlqerorë e silicorë. Shkalla e çimentimit është e ndryshueshme nga e dobët deri e lartë. Trashësia e këtyre formacioneve në qendër të tyre shkon deri në 150 m. Takohen në pjesën qendrore- jugore të rajonit të qarkut, si në Ujështrëz, Prosek, Përlat Qendër, Tarazh, Rrëshen deri në Ndërfushaz. Depozitimet mollasike të Pliocen-Kuaternarit (N2-Qp). Takohen në pjesën qendrore- veriperëndimore të qarkut, në Rasin e Butë (VP i Ungrejtit dhe JL të Kalivaçit). Vendosen në pjeset e ulëta të relievit, në mënyrë transgresive mbi vullkanitet, gabrot e ultrabazikët. Përfaqësohen nga ndërthurje konglomeratesh e ranorësh me ndërshtresa argjilore, me shkallë relativisht të ulët çimentimi. Përbërja e copave është kryesisht ofiolitike (vullkanite, gabro, ultrabazike), më pak takohen copa gëlqerorësh, silicorësh etj. Trashësia e tyre në qendër të strukturës shkon deri 70 m. C - Shkëmbinj të dobët me rezistencë në shtypje njëboshtore me pak se 50 bar. Në këtë grup kemi klasifikuar depozitimet e përziera të shpatit. Depozitime të vjetra të Kuaternarit të padijagjenizuara (De). Gjejnë përhapje në disa zona tektono - faciale, zonën "Mirdita", N/zonën "Krasta", dhe zonën "Kruja". Përfaqësohen nga depozitime të përziera deluviale - koluviale c,d,p Qp3-h. Janë kryesisht brekçie shpati me trashësi të madhe dhe çimentim argjilo - alevrolitor të dobët deri mesatar. Takohen përgjatë vargmaleve gëlqerore, flishore apo ofiolitike. Në territorin e bashkisë takohen në zonën Rabosht- Kallmeti i Madh - Fishtë, Manati, Vinjollë, Shëngjin (Fan) dhe Mërkurth. D - Dherat pa lidhje kohezionale (c=0). Në këtë grup përfshihen: (R) depozitimet detare Qh dhe (P) depozitimet e shtratit të sotëm të lumit Qh. Në hartat e shkallëve më të mëdha kanë simbole moshore

---

depozitimet detare (dQh2) dhe ato të shtratit të sotëm të lumit (al Qh2). Depozitimet detare (R) kufizohen nga deti Adriatik dhe kanë trajtën e një rripi përgjatë detit nga grykëderdhja e Ishmit deri në portin e Shëngjinit. Gjatë shtrirjes së tyre formojnë plazhet e Patokut, Tales e Shëngjinit. Janë rëra nga kokërrimëta deri kokërrmëdha me ngjyre gri, me trashësi nga 2m deri 5-6m. Depozitimet e shtratit të lumit (P) përhapen në rrjedhën e sipërme dhe të mesme të lumenjve, janë kryesisht zhavorre kokërrmesëm-të trashë deri popla me rrumbullakësim jo të mirë deri të rrumbullakosura, me zaje gëlqerori, gabrosh, ultrabazikë, silicorë e ranorë. Trashësia e këtyre depozitimeve varet nga pozicioni i rrjedhës së lumit. Në rrjedhën e sipërme trashësia e zhavorreve mund të jetë deri 2m, por mund të shkojë deri 3-4m. Me kalimin nga rrjedha e sipërme në atë të mesme trashësia e depozitimeve të shtratit rritet (10 - 15 metra), por dhe gjerësia e shtratit rritet, nga disa metra në dhjetra metra, e në ndonjë rast rreth 150 -200m. E - Dherat me lidhje kohezionale ( $c \neq 0$ ) Suargjila të vendosura mbi zhavorret (Szh), janë depozitimet në tarracat lumore (Qh), janë shënuar me simolin moshor (al Qh1). Ato formojnë relievin fushor të zonës nga Shliza në jug, Fushë Milot - Gurëz deri në rrjedhën e lumit Drin (fusha e Gramshit). Suargjilat janë me origjinë aluviale, kanë trashësi nga 2.0m deri në 8.0m dhe vendosen po mbi depozitimet aluviale të perfaqesuara kryesisht nga zhavorre. Trashësia e zhavorreve mund të shkojë 20 – 30 m. Shpesh herë këto depozitime ndërthuren me depozitimet kënetore të formuara në të dy anët e shtratit të lumit (Allkja S. 2001). F - Dherat me veti speciale (LAKr) Në këtë grup dherash janë klasifikuar depozitimet kënetore liqenore të cilët në hartën përkatëse kanë simbolin IQh2. Ato kanë veti fiziko - mekanike të dobëta dhe janë kryesisht në prezencën e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Takohen në zonën tektono faciale "Kruja", në pjesën fushore ndërmjet malit të Kakariqit dhe të Rencit dhe në UPA nga Ishull Shëngjini deri në grykëderdhjen e lumit Ishëm. Zgjerohet drejt lindjes duke përfshirë fushën e Barbullosë, fushën e Rrilës dhe të Spitenit deri në afërsi të Shënkollit, Grykës së Lumit deri në Tale 2, vazhdon në jug të Fushë Kuqes (Alku) deri në grykëderdhjen e lumit Ishëm, ndërmjet fushës së Gjollit të Zi dhe fushe Gjonëmit.

### **Sizmiciteti**

Për vlerësimin e potencialit sizmik të territorit të Bashkisë të Lezhës është përdorur metoda probabilitare. Për llogaritjen probabilitare të rrezikut sizmik të

---

Shqipërisë kemi aplikuar metodologjinë Cornell-McGuire (McGuire, 1993)<sup>11</sup>. Sizmiciteti i vendit tonë është karakterizuar nëpërmjet modelit të zonave të burimeve sizmike. Sipas EC 8, strukturat në rajonet sizmike duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që të kënaqin këto dy kërkesa themelore: • Kërkesa e mos-shëmbjes, dhe • Kërkesa e kufizimit të dëmtimeve. Pra, për të plotësuar këto dy kërkesa të Eurokodit 8, llogaritjet e rrezikut sizmik të Shqipërisë janë kryer për dy nivele probabiliteti: 1. 10% probabilitet tejkalimi në 50 vjet (10%/50), ose 0,0021 në vit, që i korespondon një tërmeti me periodë përsëritje 475 vjet, dhe 2. 10% probabilitet tejkalimi në 10 vjet (10%/10), ose 0,0105 në vit, që i korespondon një tërmeti me periodë përsëritje 95 vjet. Pra, në llogaritjet e rrezikut sizmik për truall shkëmbor, shpejtimi (akseleracioni) maksimal i truallit - PGA si dhe shpejtimit spektrale - SA për shuarje 5 % përcaktohen për dy perioda të përsëritjes të tërmeteve: 475 e 95 vjet, për të cilat ndërtohen edhe hartat përkatëse të rrezikut sizmik. Bazuar në këtë metodikë është bërë edhe vlerësimi i rrezikut sizmik të territorit të Bashkisë të Lezhës që paraqitet në vijim. Në zonimin sizmik mbarëbotëror, Shqipëria zë vend në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili është ndër me aktive në botë. Në këtë brez, pjesa më aktive nga pikpamja sizmike është Egjeu dhe zona rrethuese e tij, ku bëjnë pjesë Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Çdo vit në këtë rajon (34-43o N; 18-30o E), ndodh të paktën një tërmet me  $M > 6.5$ . Shqipëria është një ndër vendet më sizmoaktive në Evropë. Shumica e tërmeteve të fortë ndodhin në 3 breza sizmike mirë të përcaktuara.

- Brezi tërmetor Adriatiko-Jonik në buzën lindore të mikropllakës së Adrias me shtrirje veriperëndim-juglindje;
- Brezi tërmetor Peshkopi-Korçë me shtrirje veri-jug,
- Brezi tërmetor Lushnjë-Elbasan-Dibër me shtrirje veri-lindore

Territori i Bashkisë të Lezhës zë vend në shtrirje përgjatë bregdetit të brezit tërmetor Adriatiko-Jonik, tërmetet e fuqishëm të të cilit kanë kushtezuar potencilain sizmik të saj

### **Popullsia**

Popullsia e qarkut Lezhë ka një shtrirje gjeografike mjaft të gjerë, në 1619 km<sup>2</sup>, ku natyra i ka dhuruar malin, fushën dhe bregdetin. Siç vërehet edhe nga tabelat, popullsia e qarkut Lezhë ka një rritje ndër më të lartat në vend që nga viti 1989 deri në vitin 2003, me rreth 46.279 banorë (ose 28.1%). Ekziston një

---

numër afërsisht i barabartë mes meshkujve dhe femrave. Popullsia që jeton në zonat rurale, është 60.6 %, gjë që tregon një prirje të lëvizjes së popullsisë drejt zonave urbane pas viteve 90-të.

## **5. VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**

Vleresimi i ndikimeve negative ne mjedis do te analizohet gjate ushtrimit te veprimtarisë te asgjësimit të mbetjeve spitalore dhe farmaceutike me metodën e incenerimit/pirolizës, kjo për faktin sepse impaktet negative vlerësohen të jenë me te larta ne fazen e funksionimit. Gjatë hartimit të këti materiali vlerësimi i impakteve është kryer ne baze te teknologjisë që do të operoje operatori (subjekti V.A.L.E. RECYCLING shpk). Ne vijim do te studjojme impaktet negative qe implementohen nga ky projekt per parametra te ndryshem mjedisore.

Perpara se te identifikojme ndikimet e mundshme negative ne mjedis nga veprimtaria e mesiperme dhe aktiviteti qe do te kryhen ne kompleks duhet te theksojme se shoqeria angazhohet te kontrolloje, monitoroje dhe beje perpjekje te vazhdueshme per te minimizuar ne maksimum cdo efekt negativ sado minimal ne mjedis nga veprimtaria e saj.

- Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit

Sic është theksuar edhe më lart subjekti nuk do të ndryshojë vendndodhjen e objektit, por në të njëjtën vendndodhje ne ambiente të ndërtuara rishtaz do të shtohen edhe dy linja të reja për asgjësimin e mbetjeve spitalore dhe farmaceutike të cilat do të jenë në ambiente të vecanta. Pra në karakteristikat fizike nuk perfshihen ndryshime ne topografine e siperfaqes ku do te zbatohet projekti, pasi instalimet jane egzistuese. Ky aktivitet nuk do te kete ndikim negativ ne karakteristikat fizike te zones.

- Ndikimet negative ne habitate dhe bodiverstetin e zones se projektit

Per sa i perket truallit ku do të instalohen edhe dy linjat e reja toka eshte zhveshur me pare per ndertimin e impiantit ekzistues, si pasoje nuk do te kemi nderhyrje ne habtatit dhe biodiversitetine zones.

- Biodiversiteti

Gjate kryerjes se aktivitetit te asgjësimit të mbetjeve spitalore dhe farmaceutike nuk do te kete ndikime ne biodiversitetin e zones, pasi ky aktivitet do te kryhet brenda kontureve te siperfaqes se tokes ku eshte instaluar impianti ekzistues.

- Habitat

Ndikimet ne habitat do te kene kryesisht karakter besdises por jo demtues.

- a) Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve
-



### Shkarkimet ne ajer

Shkarkimet ne ajer gjate proceseve te incenerimit dhe pirolizës në asgjësimin e mbetjeve spitalore he farmaceutike mund te shkatohen nga gazrat e motoreve me djegie te brendshme te makinerive te ngarkimit dhe te transportuesve qe do te perdoren gjate transportit te mbetjeve. Keto emetime do te jene brenda normave te lejuara. Gjithashtu ne ambientet e aktivitetit do te kete prani te ererave te pakendshme por nuk do jene shqetsuese per banoret pasi ndodhen ne nje distanc te larget nga objekti. Keto aroma behen te besdisshme vetem per punonjesit e subjektit.

### Shkarkimet ne uji

Shtesa e proceseve incinerim/pirolizë nuk ndikon ne prishjen e cilesise se ujrave perreth pasi kryhet brenda kontureve te siperfaqes se truallit ku eshte instaluar impianti ekzistues. Gjithashtu siperfaqja e truallit ku kryhet aktiviteti eshte e shtruar me betone cila mbron cilesine e ujrave nentokesor nga filtrimi i lendeve ne impiant. Do te kete ndikim te cilesise se ujrave vetem ne ato raste kur kompania shkarkon ujra ne mjediset ujore te cilet nuk permbushin kushtet e cilesise se ujrave te shkarkimit. Ky aktivitet nuk do te gjeneroj sasira te medha uji. Procesi teknologjik nuk kerkon perdorim uji. Te vetme sasi ujore qe do te gjenerohen jane ato nga ambientet higjeno-sanitare te cilat do te shkarkohen ne gropen septike qe eshte ndertuar nga shoqeria sipas kushteve te caktuara teknike.

- Prodhimi i mbetjeve

Ky aktivitet nuk gjeneron mbetje te ngurta pasi vet aktiviteti kryen grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore dhe famacutike. Mbetjet pas incenerimit në përgjithësi mund të hidhen në lëndfill. Cikli i prodhimit nuk parashikon prodhimin e mbeturinave te rrezikshme.

Asgjësimi i hirit: Një incinerator i projektuar mirë dhe që funksionon mirë shkatërron çdo mbetje infektive dhe toksike duke i ekspozuar ato ndaj një temperature mjaft të lartë për një kohë të mjaftueshme, me oksigjen të mjaftueshëm për të djegur lëndën organike, duke lënë një hir biologjikisht inert pa mbetje të djegshme. Nuk duhet të ketë letra, plastika ose pëlhura të dallueshme në hirin e incenerimit.

- Emetimi i zhurmave

Duke qene se qendrat e banuar ndodhen ne nje distance te larget nga objekti, ky aktivitet nuk eshte shqetesues per banoret. Zhurma mund te kufizohet duke ndjekur praktikat e mire-administrimit (pajisje/makineri te kalibruara). Megjithate, niveli i zhurmave te krijuara do te jete ne perputhje me udhezimin e permenduar me siper, dhe nuk do ta kaloje kete kufi. Paksa te ekspozura nga ketyre zhuramave do te jene punonjesit qe do te punojne ne objejt, per te cilet do te kerkohet zbatimi i masave te sigurimit teknik ne pune dhe midis te tjerash dhe perdorimi i kufjeve.

---

- Ndikimet social ekonomike te projektit

Per vete natyren e territorit ku do te funksionoje impianti incenerim/pirolizë, investimi per te nuk prek ne menyre negative prona private apo aktivitete ekonomike, vlera sociale etj. Gjate fazes operuese nuk pritet te kete ndikime mbi vlerat arkeologjike, historike apo kulturore etj

- Perdorimi i tokes

Implementimi i projektit nuk sjelle tjetersim te perdorimit tokes pasi objekti dhe instalimet jane egzistuese dhe nuk ka nevoj per nderhyrje te metejshme. Ky fakt nuk do te sjelli ndikime ne uljen e tokave bujqesore pasi kjo eshte prone private.

- Zhurmat

Ne fazen e funksionimit burimet e zhurmes do te vijne vetem nga automjetet e transportit te mbetjeve. Duke qene se qendrat e banuara ndodhen ne nje distance te larget nga objekti, ky aktivitet nuk eshte shqetesues per banoret e zones.

- Emetimi i pluhrave dhe grimcave ne ajer

Do te kete emetime te gazeve nga djegja e karburantit ne motoret e automjeteve qe do te kryejne transportin e mbetjeve. Keto emetime do te jene brenda normave te lejuara.

- Aksidentet e mundshme me pasoja ne mjedis

Duke qene se ne keto impiant proceset e incenerimit/pirolizës për asgjësimin e mbetjeve spitalore dhe farmaceutike nuk perdorin kimikate apo lende te ndryshme toksike, nuk do te kete aksidente te cilat shkaktojne pasoja ne mjedis. Kontaminimi i tokes nga funksionimi normal i veprimtarise eshte zero. Pasoja ne cilesine e tokes do te kete ne rast se do te kete rrjedhja te pakontrolluara te mbetjes nga automjetet e transportit. Kompania siguron funksionim te kontrolluar te aktivitetit me qellim shmangien e mundesise per kontaminimin e tokes.

- Prishja e cilesise se ajrit

Ajri eshte nje nga parametrat me te rendesihem te cilesise se mjedisit dhe kontaminimi i tij do te sillte ndryshime te medha ne cilesine e jetes. Ekziston mundesia e aksidenteve me pasoja ne cilesine e ajrit. Shkarkimet e pakontrolluara te mbetjeve ne mjedis jane nje tjetet burim i emtimit te gazeve ne ajer, por nga funksionimi i impiantit incenerim/pirolizë nuk do kete.

- Tjetersim i habitatit

Mundesia e aksidenteve te cilat sjellin tjetersim te habitatit ekzistues jane thujse zero.

- Prani te zjarrit

Prani te zjarrit mund te kemi vetem si pasoj e shendijave elektrike, por shoqeria do te mare masa duke vendosur ne ambjentet e proceseve teknologjike pajisje kundra zjarrit.

## **6. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT**

---

Identifikimi i masave për të eliminuar apo zbutur ndikimet negative në mjedis

a. Planifikimi i zones

Zhvillimi i aktivitetit është parashikuar të bëhet sipas projektit duke ruajtur procesin teknologjik. Rreth këtij objekti, është parashikuar dhe mbjellja e disa pemëve dekorative për zbukurimin dhe pastrimin e ambientit të aktivitetit.

b) Masat teknike

- udhëzim dhe trajnim i personelit lidhur me rregullimin e ndarjes së mbetjeve në burim dhe motivimi i tyre për të siguruar se ndarja është efektive;
- organizim i trajtimit dhe i asgjësimit të mbetjeve në mënyrën e duhur për çdo rrymë;
- mbajtje e regjistrave;
- monitorim i performancës së organizimit të ndarjes në burim dhe asgjësimit;
- marrje e masave korigjuese nëse është e nevojshme.
- mbylljen dhe etiketimin e kontenerëve;
- magazinimin;
- përmirësimin e planifikimit dhe para-njoftimit;
- regjistrimin e të dhënave për të gjitha fazat;

Mirëmbajtja e rregullt e inceneratorit është thelbësore për funksionimin efikas. Kjo do të sigurojë që të plotësohen kërkesat e duhura të shkarkimit si dhe të minimizohen kostot e aktivitetit total afat-gjatë. Për një ecuri sa më të mirë të punëve të impianteve shtesë incenerator/pirolizë, shoqëria parashikon çdo vit pastrim, lysterje dhe riparim të mjediseve të brendshme të objektit, sistemime e rregullime dhe mbjellje fidanesh të rinj në pjesët anësore të oborrit

c) Masat estetike dhe ekologjike

Gjatë ushtrimit të proceseve shtesë subjekti do të kryej:

- Ruajtjen e rrethimit të objektit
- Sistemimin e materialeve të ndryshme gjatë procesit të diferencimit në vende të caktuara
- Levizjen e automjeteve të ndryshme në mënyrë të kontrolluar dhe pa krijuar remuje në oborrin e objektit
- Krijimin e kushteve të përshtatshme për të mbjellë dhe kultivuar bime dhe pemë të ndryshme.

Vlerësimi i efektivitetit të pritshëm të masave zbatuese

---

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe përmirsimi i vazhdueshëm, sipas kushteve teknike të punës në zbatim të projektit, që do të çojë përfundimisht përfitimin e pamjeve të parashikuar në projekt me sipërfaqe të brendshme të sistemuara dhe me oborr të gjelberuar aty ku do të ketë hapsira të lira.

d. Plani i emergjencave

Plani i emergjencave është një ndër planet kryesore me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve, komunitetit dhe mbrojtjen e mjedisit. Personeli i këtij projekti duhet të njohë mirë të gjitha proceset që kryhen në këtë projekt në mënyrë që të arrijë të kuptojë situatën, shkaqet dhe të jetë i përgatitur për menaxhimin e avarive apo aksidenteve. Në rast se gjendemi para një aksidenti personat me të afërt duhet të japin shenjën e alarmit. Në varesi të llojit dhe madhësisë së aksidentit do të kryhet izolimi.

Masat për parandalimin e avarive dhe aksidenteve në frontin e punës janë:

- Përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve të cilat janë në gjendje të mirë teknike
- Servisim periodik i mjeteve dhe instalimeve të tjera në frontin e punës
- Çdo person para se të nisi punën në këtë projekt të nenshtrohet trajnimit për të njohur gjithë procesin teknologjik, për të njohur me rrezikun e aksidenteve dhe reagimin e tij në çdo rast emergjent.
- Në objekt të ndërtohet kendra e ndihmës së shpejtte dhe të jetë i njohur nga të gjithë personat e punësuar.
- Në objekt të vendosen tabela/njoftime ku tregohen pikat kyçe të rrezikut, të publikohen numrat e kontaktit të supervisorit të emergjencave.

Linja do të ketë Një rregullore të brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore , një plan për administrimin e mbetjeve spitalore, që duhet të përmbajë minimalisht informacionin e mëposhtëm:

- a) përshkrim të mbetjeve spitalore të prodhuara dhe nga gjenerojnë , duke përfshirë llojin, peshën dhe vëllimin;
  - b) një përshkrim të procedurave të kërkuara për administrimin e mbetjeve
  - c) një përshkrim të zonës brenda dhe jashtë saj, ku prodhohet depozitohet apo trajtohet mbetja spitalore;
  - d) destinacionin, metodat e trajtimit dhe të asgjësimit për çdo lloj mbetje spitalore;
  - e) procedurat dhe veprimtaritë për kualifikime në administrimin e mbetjeve spitalore;
  - f) veprimtaritë informative që lidhen me shëndetin, sigurinë dhe asgjësimin e rregullt të mbetjeve spitalore për të gjithë personat që mund të bien në kontakt me to;
  - g) procedurat dhe pajisjet e kontrollit të ndotjes dhe të pastrimit;
-

keto lloj mbetjesh nuk duhet të presohen apo t'u nënshtrohen veprimeve të sforcuara mekanike

Impianti për trajtimin ose asgjësimin e mbetjeve nuk do të pranojë nga prodhuesit mbetje spitalore në rast se nuk janë shoqëruar me fletë-dorëzimi, në përputhje me ligjin nr.9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme".

Impianti do të mbajë regjistrime të pranimeve, që minimalisht përfshijnë informacionin e mëposhtëm: a) emrin dhe adresën e prodhuesit; b) peshën e mbetjeve të pranuar; c) datën dhe orën e pranimit të mbetjeve; dhe d) nënshkrimin e personit që pranon mbetjet.

Të gjitha regjistrimet që bëhen sipas kësaj rregulloreje, ruhen për një periudhë deri në shtatë vjet.

#### e. Trainimi i Personelit

Trainimi do të mbulojë aspektet e shëndetit dhe sigurisë gjatë kryerjes së proceseve të punës. Trainimi mjedisor do të referohet kushteve aktuale mjedisore, ndikimeve potenciale mjedisore të punës që do të bëhet dhe zbatimit të masave specifike parandaluese për eliminimin apo minimizimin e ndikimeve negative.

Një plan trainimi do të zhvillohet për të siguruar se personeli përkatës ka marrë trainimin e duhur dhe kompetencat për kryerjen e punës së tij.

Subjekti është i detyruar që në rast aksidentesh të njoftojë institucionet përkatëse për menaxhimin e situatave me qëllim zvogelimin e impakteve mjedisore dhe rrezikut që mund të preke jetën e punonjësve apo dhe banorëve.

Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit, përbehet nga fikse zjarri portative, rezervar uji, rrufe pritesa dhe rrjet tokezimi, kosha metalike dhe tabelave sinjalizuese. Do të jete funksional gjatë fazës së operimit të veprimarisë.

Shoqëria ka përgatitur një dokument për vlerësimin e rrezikut në vendin e punës. Në këtë dokument janë përcaktuar dhe vlerësuar të gjitha rreziqet që lidhen me aktivitetet e punës dhe janë përpunuar të gjitha masat e duhura për të reduktuar rrezikun mbi aktivitetet e kryera nga punëtorët në të gjitha departamentet.

I gjithë personeli trajnohet në bazë të dokumentacionit të vlerësimit të rreziqeve. Ky dokument, është vendosur në dispozicion të punonjësve dhe mund të jete lehtësisht i aksesueshem nga kushdo prej tyre edhe gjatë orarit të punës.

Në objekt adoptohen sisteme mbrojtëse kolektive dhe individuale. Në këtë drejtim, të gjithë punonjësit marrin pajisjet mbrojtëse personale të parashikuara me ligj në bazë të aktivitetit të zhvilluar dhe tipologjisë së mbetjes së trajtuar e (p.sh. doreza dhe syze mbrojtëse). Në ambientet e kapanonit janë vendosur tabela të cilat shpjegojnë mënyrën e përdorimit të mjeteve të ndryshme të punës dhe kujtojnë detyrimin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse në varesi të punës dhe operacionit të zhvilluar.

---

Perfundimisht mund te thuhet se ndikimet ne mjedis te kesaj veprimtarie jane te pranueshme dhe normale.

Shoqeria do te realizoje nje monitorim te vazhdueshem te veprimtarise se saj. Te dhenat qe do te mblidhen nga monitorimi do te sherbejne per te ndermarre masa permiresuese ne lidhje me operacione te ndryshme me ndikim ne mjedis. Te dhenat e grumbulluara nga monitorimi do te dorezohen rregullisht prane Agjencise Kombetare te Mjedisit dhe Inspektoriatit Shteteror te Mjedisit dhe Pyjeve.

Mbrojtja e mjedisit do te jete gjithmone nje element i nje rendesie te jashtezakonshme ne drejtimin e vendimeve te biznesit ne lidhje me teknologjite qe do te perdoren.

1. Projekti eshte hartuar mbi bazen e teknologjive me te mira te mundeshme ne fushen perkatese;
  2. Zbatimi i projektit do te kontribuojte ne nje rritje ekonomike ne nivel lokal dhe kombetar, si dhe ne rritjen e mundesive per vende te reja pune, nepermjet bizneseve qe do te gjenerojte ky projekt.
  3. Projekti nuk ka shkarkime ne mjedis dhe ndihmon organet shteterore te ruajne cilesine e mjedisit.
-